


# Mediat digjitale në Kosovë: Në kontroll të baraspeshës mes lirisë së shprehjes dhe reputacionit



Projekt i financuar nga BE-ja  
dhe i menaxhuar nga Zyra e  
Bashkimit Evropian në Kosovë



## Shmangie e përgjegjesisë:

Ky publikim është prodhuar me përkrahje të Bashkimit Evropian. Përm-bajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e LENS dhe nuk mundet në asnjë mënyre të merret si pikëpamje e Bashkimit Evropian.

Pikpamjet e shprehura në këtë punim nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikpamjet e Friedrich-Ebert-Stiftung (FES).

Nuk lejohet përdorimi komercial i materialeve të publikuara nga Friedrich-Ebert-Stiftung, pa pëlqim me shkrim nga vet FES.



# PËRMBAJTJA

Shmangie e përgjegjësisë:.....	3
Përmbledhje ekzekutive .....	6
Termet dhe Definicionet .....	7
Hyrje.....	9
Metoda e hulumtimit .....	12
Puna ne tavolinë .....	12
Puna në terren.....	12
Kërkesat për informacionet .....	12
Analiza ligjore.....	13
Struktura institucionale .....	17
Cjetjet e hulumtimit.....	22
Llogaridhënia institucionale .....	22
Vendimet e gjyqësorit .....	28
Integriteti profesional.....	32
Rekomandimet .....	37
Shtesat.....	39
Shtesa 1   Vështrim i Literaturës .....	39
Shtesa 2   Lista e të anketuarve .....	41
Shtesa 3   Pyetësi i Strukturuar.....	42



## Përmbledhje ekzekutive

Rritja e mediave digjitale mishëron në vete atë që quhet demokratizimi i lirisë së shprehjes. Ajo nuk sheh kufij informacioni, që do të thotë se pajtohet që gjithsecili të jetë shkrimtar, transmetues ose botues. Me gjithë këta pjesëmarrës të përfshirë në komunikimin digjital, ka rrezik që një rritje e potencialit të të shprehurit mund të cenoj të drejtën e privatësisë dhe të reputacionit. E drejta e privatësisë në kontekst të këtij studimi përkufizohet si e drejta për të qenë vetëm, dhe i atribuohet mbrojtjes së reputacionit të individëve.

Në Kosovë, liria e shprehjes është një e drejtë kushtetuese, e përkufizuar në pajtim me parimet e përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nuk është një e drejtë absolute, që do të thotë se të drejtat e njeriut nuk mund të ushtrohen në atë mënyrë që i kërcënojnë të drejtat e tjetrit. Kjo është perspektiva e përgjithshme që ky studim e mbron duke argumentuar se mediat digjitale në Kosovë gjithnjë e më shumë janë duke u shndërruar në një kërcënim për tu përdorur për qëllime të shpifjes ndaj tjerëve ose për t'i ofenduar ata. Këtë e bën duke e vënë theksin në shpifjen në kontekstin e mediave digjitale e cila si koncept e tërheqë një vijë të hollë mes ligjit dhe praktikës ose gazetarisë së mirë dhe të keqe.

Në fakt, shpifja praqet një kufi mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për privatësi. Pyetja është si këto të drejta reciprokisht përforcuese mund të baraspeshohen. Do të thotë, në çfarë mase mund mediat digjitale të mbahen përgjegjëse për përdorim të përmbajtjes dëmtoese? Siç pretendon ky studim, përfundimisht varet nga niveli i dhënies së përgjegjësive të institucioneve përkatëse dhe integritetit të mediave digjitale. Përderisa legjislatura kombëtare është në favor të lirisë së shprehjes dhe mediave, ajo nuk cakton udhëzime të qarta ose një set përgjegjësish institucionale kur është fjala për rregullimin e mediave digjitale dhe shtypit online. Kjo na sugjeron që disa dispozita dhe rregulla të legjislacionit duhet të amandamentohen për të kërkuar llogaridhënie të veçantë nga ana e Komisionit të Pavarur për Media (KPM) për të mbikëqyrur përmbajtjet online, duke pasur parasysh që për momentin ajo mbetet kryesisht e parregulluar.

Në praktikë, siç tregojnë gjetjet kryesore, mediat dhe autoritetet gjyqësore vlerësohen si jo-efektive në kërkimin e përgjegjësive nga mediat për

prodhimin e përmbajtjes së dëmshme. Autoritete rregullatorë janë në një masë të anshme dhe kane mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe financiare për të ushtruar autoritetin e tyre monitorues për të kontrolluar dhe t'u ndërroj mendjen mediave digjitale nga dëmtimi i reputacionit të individëve. Kur sistemet rregullatorë ose të llogaridhënies nuk punojnë me efikasitet, duhet të jetë detyrë e gjyqësorit për të baraspeshuar lirinë e shprehjes dhe reputacionin. Megjithatë, për të dhëne vendime gjyqësore pas një padie, gjyqësorit i mungon dijenia dhe vetë-iniciativa për të gjykuar nëse reputacioni i një individ është dëmtuar, duke u bazuar në një gjyqësor i cili është shumë më tolerant ndaj lirisë së shprehjes. Në mungesë të mekanizmave efektive llogaridhënëse, sjellja e mediave digjitale është mjaft shqetësuese. Siç tregojnë gjetjet kryesore, ka mungese të pavarësisë dhe integritetit të mediave digjitale. Në Kosovë, ka vështirësi për të mbajtur standardet e etikës së gazetarisë. Në një situatë të pafavorshme ekonomike, përfitimet financiare konsiderohen me prioritet për mediat digjitale në mënyre që të mbijetojnë dhe t'i avancojnë përfitimet nga reklamat. Sigurisht, kjo e vendos Këshillin e Mediave dhe Asociacionin e Gazetarëve në vështirësi kur është fjala për mbrojtjen e reputacionit të individëve në kurriz të lirisë së shprehjes, tani që ata nuk e kanë më mbështetjen financiare që ata dikur merrnin nga ndërkombëtarët. Nevoja që ata të bëhen të vetë-qëndrueshëm është më e rëndësishme se kurrë, dhe rritjes së përpjekjeve të tyre për mbajtjen përgjegjës dhe edukimin e mediave digjitale në lidhje me shpifjen dhe fyerjen.

## Termet dhe Definicionet

Media digjitale, për qëllime të këtij raporti, përbëhet nga “platformat digjitale (p. sh. ueb faqet dhe aplikacionet), përmbajtja e digjitalizuar (p.sh. teksti, audio, video, dhe fotografitë) dhe shërbimet (p.sh. informacionet, argëtimi dhe komunikimi) që mund të qasen dhe konsumohen përmes pajisjeve të ndryshme digjitale.”<sup>1</sup>

Shpifja është një term i përgjithshëm i cili sipas Ligjit Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji Nr. 02/L-65) do të thotë “publikimi i një fakti ose një deklarate të pavërtetë dhe botuesi e di ose duhet ta dijë se fakti apo deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.”<sup>2</sup> Çështja e lëndës, “reputacioni i tjetrit/tjerëve” është termi

1 Forumi Ekonomik Botëror. Mediat Digjitale dhe Shoqëria. Janar 2016, fq. 5.

2 Gazeta Zyrtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2503> Neni 3, Maj 2008, f. 2



që përdoret në PNDKP (Neni 19) dhe KEDNJ (Neni 10) si baza legjitime për të kufizuar të drejtën e lirisë së shprehjes. Dy termet me të njohura ligjore të cilat e përcaktojnë shpifjen dhe kërcënimin e saj për të cenuar reputacionin e tjetrit/tjerëve janë botimi i shpifjes dhe përgojimi. Duke pasur parasysh që dallimi mes këtyre dyjave praktikisht është zhdukur dhe nuk janë përcaktuar në pajtim me legjislacionin ekzistues, ato do të përdoren në vend të njëra tjetrës.

Botimi i shpifjes më shumë definohet si një deklaratë shpifëse që është e publikuar ose në formë të shkruar ose ndonjë formë tjetër si transmetimi.<sup>3</sup> Përgojimi, megjithatë, definohet më shumë si një deklaratë e folur ose orale shpifëse dhe nuk ruhet në asnjë formë të përhershme. Nga të dy termet, “botimi i shpifjes konsiderohet më dëmtues sepse është fikse dhe mund të qarkullojë gjerësisht.”<sup>4</sup> Fyerja është një tjetër formë e shpifjes e cila nuk gjendet në definicionet ndërkombëtare të mbrojtjes së reputacionit. Por në kontekstin lokal, ajo është e rregulluar në pajtim me legjislacionin kundër shpifjes, e definuar si një deklaratë ose sjellje e destinuar që të poshtëroj tjerët (p.sh. zyrtarët, simbolet shtetërore, institucionet).<sup>5</sup>

Koncepti i reputacionit është një term i rëndësishëm duke pasur parasysh se përdoret si bazë për të kufizuar lirinë e shprehjes. Mund të themi se shpifja është çështje e së drejtës së individit për reputacion. Disa pyetje retorike lindin kur definojmë reputacionin. A i referohet individëve të cilët janë më të njohur publikisht se sa tjerët? Nëse po, a nënkupton kjo se ata kanë reputacion me të madh në krahasim me qytetarët e thjeshtë? Supozimi është se figurat publike janë më të ndjeshëm për tu fyer dhe të ketë shpifje ndaj tyre. KEDNJ shpesh ka theksuar që figurat publike duhet të nënshtrohen lirisë me të madhe për kritika në krahasim me tjerët. Megjithatë, Iniciativa për Mbrojtjen Ligjore të Mediave (IMLM) dhe Instituti Ndërkombëtar i Mediave (INM) e definojnë termin reputacion të aplikueshëm për të gjithë dhe e definojnë atë me dinjitetin njerëzor si të drejtë bazë njerëzore.<sup>6</sup> Në përputhje me këtë, kuptojmë se një person i thjeshtë vlen të mbrohet po aq sa figurat publike aktivitetet e se cilave raportohen çdo ditë.

**Kështu, secilit individ vlen t’i mbrohet reputacioni në pajtim me parimet**

3 IMLP & INM. Liria e Shprehjes, Ligji i Mediave dhe Shpifjes Shkurt. Shkurt 2015, f. 6. <http://www.mediadefence.org/sites/default/files/resources/files/MLDI.IPI%20defamation%20manual.English.pdf>

4 Packard, Ashley. [Ligji mbi Mediat Digjitale](#). Wiley-Blackwell. 2010, fq. 180.

5 Gazeta Zyrtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2503> Neni 3, Maj 2008, fq. 2

6 IMLP & INM. Liria e Shprehjes, Ligji i Mediave dhe Shpifjes Shkurt 2015, fq. 21. <http://www.mediadefence.org/sites/default/files/resources/files/MLDI.IPI%20defamation%20manual.English.pdf>



e PNDCP dhe KEDNj. Në Nenin 12 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, thuhet: Askush nuk duhet të jete subjekt i ndërhyrjes arbitrare ne privatësinë, familjen, shtëpinë ose korrespondencën e tyre, e as ndaj sulmeve mbi nderin dhe reputacionin e tyre.”<sup>7</sup> Kjo rezonon me Nenin 17 të PNDCP dhe Nenin 8 të KEDNj që e përkufizojnë reputacionin si një atribut i identitetit personal dhe integritetit psikologjik që hyn në fushën e privatësisë së jetës së individit. Privatësia është një tjetër koncept i cili mbrohet dhe definohet me reputacionin. Respekti për privatësinë mund të shihet si mënyrë e mbrojtjes së reputacionit, që tregon se privatësia si e drejte mund të forcohet nga anonimiteti.<sup>8</sup> Shpifja si cenim i reputacionit mund të vij përmes të folurit e cila cenon privatësinë. Megjithatë, jo të gjitha cenimet e privatësisë rezultojnë ne cenim te reputacionit dhe anasjelltas<sup>9</sup>.

## Hyrje

Rritja domethënëse që kanë pasur mediat online vitet e fundit ka qenë një sukses në Kosovë. Kosovarët po kalojnë gjithnjë e më shumë kohë online, duke përdorur media sociale dhe media digjitale duke përdorur pajisje mobile, që padyshim ka rezultuar në përmirësimin e qasjes në lajme dhe informacione. Penetrimi i internetit neper shtëpi ka arritur gati 76% - një rritje prej 2% në dy vitet e fundit sipas Raportit të Progresit (2016) të Komisionit Evropian (KE)<sup>10</sup>. Përderisa mediat digjitale nga lap topët dhe kompjuterët desktop dominojnë, penetrimi i telefonisë mobile gjithashtu është rritur, duke arritur 97% të përdoruesve aktiv<sup>11</sup>. Përkundër faktit se mediat tradicionale dhe digjitale vazhdojnë të dominojnë hapësirën informative, ato nuk janë më operatorët e vetëm. Ngritja e mediave sociale ka sjellë ndryshime domethënëse në industrinë e lajmeve. Ne Kosovë, ka më shumë se 860,000 përdorues nga Qershori 2016 duke arritur një shkallë të penetritit deri ne 50 përqind.<sup>12</sup> Rrjedhimisht, publiku nuk shikon më vetëm tek fuqia e portaleve dominuese online siç janë Gazeta Express ose Indeksonline. Mediat sociale po u përshtaten vazhdimisht fuqisë në rritje të vetë përdoruesve si shpërndarës te informacionit.

7 Asambleja e Përgjithshme e Komeve të Bashkuara, Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut Dhjetor 1948, Neni 12, fq 12

8 Berger, Guy, Liria e Shprehjes, Privatësia dhe Shpifjet ne Internet, Universiteti i Maltës, Shkurt 2016

9 Berger, Guy, Liria e Shprehjes, Privatësia dhe Shpifjet ne Internet, Universiteti i Maltës, Shkurt 2016

10 Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën (2016) Nëntor 2016, fq, 41

11 Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën (2016) Nëntor 2016, fq, 61

12 Statistikat Botërore të Internetit, Kosova, Qershor 2016. (E qasur me 23 Prill, 2017)



Duke pasur parasysh rritjen e informacioneve në dispozicion, sondazhet e opinionit publik tregojnë se ka një ndjenjë të përparimit kur është fjala tek liria e shprehjes dhe mediat. Duke u bazuar nga anketa e Public Pulse (Pulsi Publik) e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), perceptimi publik mbi atë nëse Kosova ka liri të shprehjes ka arritur 47% në Prill 2016, nëse krahasohet me 29% në Nëntor 2010<sup>13</sup>. Kjo është një përqindje relativisht e lartë e besimit dhe një përmirësim substancial me mediat që tejkalojnë institucionet tjera (p.sh qeverinë, gjyqësorin, etj)

Kohët e fundit, mediat digjitale kanë fituar popullaritet të ndjeshëm në kurriz të shtypit tradicional sepse mund të sjellin informacione të shpejta, reaguese, dhe të llojllojshme pa asnjë kosto. Kjo, nga ana tjetër, e ka dëmtuar profesionin e gazetarisë. Nga perspektiva e Agron Demit, një aktivist i shoqërisë civile nga instituti GAP, “lajmet në kohën tonë nxiten nga shpejtësia në vend të përmbajtjes dhe saktësisë.”<sup>14</sup> Termi “shpejtësi” i referohet mënyrave të mediave digjitale për të prodhuar kryetituj të shpejt dhe që bien në sy, të cilat nuk janë të bazuara në fakte të hulumtuara mirë dhe synojnë vetëm rritjen e të ardhurave nga klikimet në internet.

Në kontekst të këtij studimi, mediat digjitale ofrojnë hapësirë për lirinë e shprehjes duke lejuar individët të bëhen krijues të përmbajtjes, dhe duke u mundësuar atyre të merren me akte të shpifjes dhe fyerjes. Rrjedhimisht, nëse liria e shprehjes nuk kontrollohet si duhet, media digjitale mban fuqi të tepruar dhe shume lehtë mund të cenoj privatësinë dhe reputacionin e individëve. Komisioni Evropian (KE), në raportin e tyre të fundit të progresit, ka ritheksuar që liria e shprehjes nuk është monitoruar mirë nga autoritetet rregullatorë, duke iu referuar Komisionit të Pavarur për Media (KPM) dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).<sup>15</sup>

Për shkak se ka një zbrazëti rregulluese kur është fjala të mbikëqyrja e shtypit online, si KPM-ja, ashtu edhe KMSHK-ja tërhiqen nga përgjegjësia e tyre morale për mbrojtjen e të drejtave të individëve nga përmbajtja e dëmshme online. Asnjëri institucion nuk mbahet përgjegjës për shtypin online. KPM-ja, në njërin anë funksionon si organ rregullator shtetëror, dhe ligjërisht është përgjegjës vetëm për mediat transmetuese. KMSHK-ja në anën tjetër, funksionon si organ vetë-rregullues dhe ka të drejtë të promovoj lirinë e shprehjes pa autoritet ligjor për t’i mbajtur përgjegjëse mediat digjitale për akte të sjelljes së keqe e cila mund të jetë ofenduese

13 Programi për Zhvillim I Kombeve të Bashkuara (UNDP). Pulsi Publik. Maj 2016, fq. 8

14 Demit, Agron. [Shpejt dhe fals](#). Prishtina Insight. 28 Prill 2017

15 Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën (2016) Nëntor 2016, fq. 41

për të tjerët.

Në Kosovë, kufizimi i lirisë së shprehjes paraqet një sfidë sepse nuk është e qartë sa autoritet duhet të aplikohet, pasi që “nuk ka mënyra të rregullimit të përmbajtjes ndërkombëtarisht, e as një konsensus mbi normat që duhet të aplikohen.”<sup>16</sup> Përpjekjet për të dekriminalizuar shpifjet kanë qenë të suksesshme në vitin 2012. Kohët e fundit, qeveria ka paraqitur një nismë të dështuar politike për amendamentimin e Kodit Penal me të cilin çdokush, përfshirë mediat, do të kishte përgjegjësi penale për përdorim të shpifjes dhe fyerjes. Në veçanti, Neni 134/D i amendamentit të propozuar, që i ngjason dispozitave të modelit Gjerman, thoshte se kushdo që shpif për një organ kushtetues, duke përfshirë Presidentin, Parlamentin, Qeverinë, dhe Gjykatën Kushtetuese, mund të dënohet me tre muaj deri në pesë vjet burg.<sup>17</sup>

Përfundimisht, qeveria u tërhoq nga propozimi për shkak të presionit të shtuar nga shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar. Iniciativa ishte parë si një hap drejt kufizimit të lirisë së shprehjes dhe medias. Nga perspektiva e shumë ekspertëve ligjor dhe aktivistëve të medias, adoptimi i modelit Gjerman nuk kishte kuptim logjik, kryesisht për shkak të mekanizmit të dobët të përgjegjësi-dhënies që ekziston në Kosovë. Te marrim për shembull sistemi gjyqësor. Duke pasur parasysh që gjyqësori në Kosovë mendohet të jetë i ndikuar politikisht dhe profesionalisht i pa-aftë, ka gjasë që Kodi Penal mund të përdoret për të shtypur mediat. Në Gjermani, ekziston gjyqësor gati perfekt ku gjykatësit dhe prokurorët kalojnë në shume nivele të arsimimit dhe verifikimit.<sup>18</sup>

Duke e pasur parasysh sfidat rregullatore në Kosovë të identifikuar nga KE, dhe mos-efikasitetit të gjyqësorit për të zgjidhur rastet e shpifjes, ky studim synon të nxis një debat të vazhdueshëm rreth asaj se në çfarë mase mund të ketë baraspeshë mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për privatësi. Pyetjet kryesore të adresuar në këtë studim përfshinë si në vijim: Sa efektive janë mekanizmat e llogaridhënies në praktikë? Në çfarë mase janë institucionet gjyqësore të trajnuara dhe sa shpejt reagojnë për të zgjidhur rastet e shpifjes? A sillen gazetarët në pajtim me rregullat e kodit të tyre të sjelljes? Pyetjet e ngritura shihen në listën e një numër intervistash të bëra me gazetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve përkatëse.

16 Puddephatt, Andrew E drejta e shprehjes së lirë në epokën digjitale OSF, Prill 2011, fq. 9

17 Limani, Lura. Draft Amendamenti mbi Shpifjen merr kritika në Kosovë. Prishtina Insight. 27 Prill 2017

18 Limani, Lura. Draft Amendamenti mbi Shpifjen merr kritika në Kosovë. Prishtina Insight. 27 Prill 2017



## Metoda e hulumtimit

Qasja e hulumtimit përbehet nga analiza kualitative e ndikimit të mediave digjitale në lirinë e shprehjes dhe të drejtës së privatësisë. Hulumtimi i vë shumë theks rëndësisë përvojave të individëve të cilët janë të përfshirë në media. Është një proces i orientuar dhe jep një perspektive të brendshme përmes teknikave standarde të hulumtimit duke përfshirë hulumtimin në tavoline dhe në terren. Këto metoda e ndihmojnë raportin të marr një pamje me të gjere të mediave digjitale dhe implikimet në të drejtat e njeriut.

### Puna ne tavolinë

Puna ne tavolinë konsistoi me rishikim të potë të literaturës në burimet vendore dhe ndërkombëtare të cilat prezantohen në Shtesën 1. Këto burime janë hulumtuar online dhe janë interpretuar përderisa është bërë hulumtimi dhe shkruar raporti. Ato kanë sjellë njohuri të reja, shumëllojshmëri, dhe një perspektive me te gjerë në hulumtim. Me qasjen e orientuar nga veprimi, raporti synon të kontribuoj në debatin e vazhdueshëm mbi mediat digjitale dhe kërcënimet potenciale për te drejtat dhe liritë e individëve. Të gjitha burimet janë shqyrtuar me qellim të identifikimit çështjet më të rëndësishme në fushën e mediave digjitale nga perspektiva e shpifjes dhe fyerjes.

### Puna në terren

Puna ne terren përfshiu një proces të mbledhjes së të dhënave nga intervistat dhe kërkesat e dokumentuara tek institucionet përkatëse mbi të dhënat e ankesave palëve të treta ne lidhje me rastet e shpifjes. Ne total, tetë intervista janë bërë me ekspert të mediave dhe përfaqësues të institucioneve përkatëse duke përdorur pyetësor të strukturuar i cili është bërë gjatë dizajnit dhe zhvillimit të raportit. Për listën e të anketuarve shih Shtesën 2. Kjo pjese e hulumtimit merret me mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e informacioneve në format jo-numerik. Për më shumë informata mbi përmbajtjen, referojuni strukturës së pyetësorit të hulumtimit në Shtesën 3 dhe pjesës së gjetjeve.

### Kërkesat për informacionet

Përveç kësaj, një numër kërkesash për informacione janë dorëzuar tek autoritetet rregullatorë të mediave (d.m.th Komisioni i Pavarur për Media dhe Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës) dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) ose Akademisë së Drejtësisë me qëllim të vlerësimit të gatishmërisë së tyre për të adresuar ankesat nga palët e treta rreth shpifjes dhe fyerjes. Për më tepër, një kërkesë për informacion është dërguar tek Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) mbi numrin e moduleve të dizajnuara dhe të dorëzuara tek gjykatësit në fushën e shpifjes dhe fyerjes.

## Analiza ligjore

Në përgjithësi, legjislati momental është i favorshëm për mediat dhe komunikimet digjitale. Disa masa të caktuara ligjore janë të garantuara me ligj sa i përket lirisë së shprehjes, mediave të pavarura, dhe të drejtës për privatësi. Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes dhe të mediave me Nenin 40 dhe 42, që lejojnë gjithsecilin të shpërndaj dhe pranoj informacione, mendime dhe mesazhe tjera pa pengesë<sup>19</sup>. Ekziston një përjashtim prej kësaj direktive në rast se është e nevojshme për të parandaluar ndonjë rrezik të dhunës armiqësisë në bazë të racës, kombësisë, apo religjionit<sup>20</sup>.

E drejta e privatësisë është po aq e rëndësishme sipas Kushtetutës së vendit e definuar si një e drejtë natyrale thelbësore për të kërkuar jetë dhe liri. Është një e drejtë absolute dhe vlen njëtrajtshëm për të gjitha situata dhe të gjitha kategoritë e njerëzve. Neni 36 i Kushtetutës thotë: “Gjithsecili gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta e tij/saj private dhe familjare.”<sup>21</sup> Përderisa nuk ka një ligj të veçantë mbi privatësinë, Kushtetuta, për më tepër i garanton secilit person mbrojtjen e të dhënave personale,<sup>22</sup> që rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky ligj ka një ndikim të përgjithshëm në informatat personale të individëve dhe ka ndikim në fusha të ndryshme të politik-bërjes. Në përputhje me këtë, të dhënat personale përbëhen nga çdo informacion që lidhet me personat natyral të identifikuar ose të identifikueshëm “duke iu referuar një numri identifikues ose të një e më shumë faktorësh specifik për identitetin e tij/saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social.”<sup>23</sup>

19 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 40 dhe 42, fq. 12

20 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42, fq. 12

21 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 36, fq. 9

22 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 36, fq. 10

23 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 03/L-172 mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale Neni 2, Prill 2010, fq. 1



Përderisa nuk ka një ligj të veçantë për media, ka një numër të masave mbrojtëse të cilat rregullojnë mediat. Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë (Ligji Nr. 04/L-137) rregullon se si burimet e informimit duhet të mbrohen dhe si mediave nuk mund tu mohohet mbrojtja e të drejtave dhe privilegjeve të tyre. E drejta bazë që ka mandat me këtë ligj, në të njëjtën vije me disa dispozita të Kodit Penal, është “e drejta për të qëndruar heshtur në lidhje me burimet e informacioneve (të mediave).<sup>24</sup> I referohet identiteti, prejardhjes, autorit dhe përmbajtjes së informacionit<sup>25</sup>. Në kontekst të rasteve të shpifjes, raportet e mediave zakonisht llogarisin në burime të fshehta, dhe mbrohen nga zbulimi i burimeve, me përjashtim kur gjykata vlerëson se informacioni është i nevojshëm të zbulohet në mënyre që të parandalohet një kërcënim serioz. Gjykata mund vetëm “të kërkoj të pandehurit në një veprim shpifës ose fyes me këtë ligj (Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes) të zbuloj informacion relevant për të përcaktuar të vërtetën e materialit të publikuar por pa e identifikuar burimin.<sup>26</sup>

Mediat digjitale qeverisen nga një set ligjesh dhe rregullash, disa prej të cilave lidhen me shpifjen dhe fyerjen. Për secilin rast që është bërë një shkelje përmes botimit të informacioneve shpifëse, duhet të bie në kategorinë e përgjegjësisë qytetare. Liria e shprehjes dhe kufizimet e saj janë të rregulluar në mënyrë më eksplicite sipas Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji Nr. 02/L-065) në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut. Tri dispozita të rëndësishme mbi kërcënimet dhe pasojat e shpifjes dhe fyerjes të vendosura në këtë ligj janë: (a) merr vendim që të mos vendos kufizime të paarsyeshme për lirinë e shprehjes për çështjet me interes publik, (b) kompensimi që i duhet bërë individëve të dëmtuar për shkak të shpifjes dhe fyerjes, (c) mediat të ushtrojnë rolin e tyre si roje dhe burim i informacionit<sup>27</sup>.

Privatësia është një koncept që mbrohet dhe definohet me reputacion. Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes lejon individët të cilët konsiderojnë se reputacioni i tyre është, ose mund të jetë dëmtuar, nga deklaratat e bëra nga të tjerët, të padis për dëme ose të parandaloj bërjen e atyre deklaratave. Ligji vlen për secilin person që është përgjegjës për përmbajtje dhe shpërndarje të deklaratave shpifëse për të cilat mediat në një masë të madhe marrin barrën e përgjegjësisë.<sup>28</sup> Në botën online, siç është rasti

24 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 03/L-172 mbi Mbrojtjen e Burimeve të gazetarisë Neni 4, Gusht 2013, fq 2

25 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 03/L-172 mbi Mbrojtjen e Burimeve të gazetarisë Neni 4, Gusht 2013, fq 2

26 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 18, Maj 2008, fq. 7

27 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 1, Maj 2008, fq. 1

28 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 5, Maj 2008, fq. 3

me Kosovën, “autori original ose krijuesi i përmbajtjes së paligjshme pothuajse gjithmonë është përgjegjës.”<sup>29</sup> Në këtë rast, autorët, redaktorët ose botuesit ose kushdo që është në kontroll të përmbajtjes dëmtuese, nuk është imun nga përgjegjësia.

Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes, megjithatë, nuk njeh ndonjë mbrojtje për autoritetet publike kur është fjala të kritikën të cilat mund ose nuk mund të jenë shpifëse ose fyese. Një klauzolë e veçantë është e vendosur në ligj e cila i “ndalon” autoritetet publike të paraqesin kërkesa për kompensim të dëmit nga shpifja ose fyerja<sup>30</sup>. Kjo është në pajtim me parimet e KEDNJ e cila ofron një numër arsyesh të mira se përse ata mbështesin mbrojtje më të vogël për zyrtarët publik: (1) liria e debatit politik si vlerë thelbësore demokratike, (2) më pak kufizime për politikanët se sa për individët privat, dhe (3) më shumë tolerancë ndaj kritikës u ngarkohet politikanëve.

Përderisa, sipas Neni 11 në fushën e përgjegjësisë, personat ose entitetet që shpërndajnë ose përpunojnë përmbajtje të paligjshme të cilën nuk e kanë krijuar vete, nuk mbahen përgjegjës.<sup>31</sup> Ofruesit e shërbimeve të internetit dhe ueb faqeve si burim i ofrimit të qasjes teknike në internet përjashtohen nga përgjegjësia, duke ofruar imunitet për te parandaluar paditë ndaj tyre. Kjo do të thotë se përdoruesit të cilët postojnë material të dëmshëm në ueb faqe dhe në platformat të mediave sociale siç janë Facebook-u janë përgjegjës për atë që shkruajnë; ueb faqet dhe operatorët e internetit të këtyre faqeve nuk janë përgjegjës. Çka është më e rëndësishme, Neni 11 përjashton secilin që “nuk ka pasur arsye për të besuar se çka ai/ajo ka bërë ka kontribuar në përhapjen e deklaratës shpifëse ose fyese”<sup>32</sup>. Kësaj gjithashtu i referohen si parimi i “publikimit të paqëllimtë” i cili tregon se cilado media digjitale nuk do të mbahet përgjegjëse nëse nuk janë në dijeni për përmbajtjen shpifëse.

Shpifja dhe fyerja definojnë si gabime civile dhe kështu nuk është një vepër penale sikurse është në shumicën e vendeve të rajonit.<sup>33</sup> Në Kosovë, nëse paraqitet një kërkesë civile, gjykata civile cakton nëse individi është fyer apo ka pasur shpifje ndaj tij në pajtim me Ligjin kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji Nr. 02/L-65) dhe Ligji mbi Procedurën e Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006). Duke u bazuar në dëshmi, gjykatësi mund ta refuzoj rastin, të detyroj një kompensim financiar ose vendos në favor të ndonjë forme tjetër të kompensimit (p.sh deklaratë e përmirësimit ose kërkim falje).

29 Wong, Cynthia & James X. Dempsey Mediat dhe Përgjegjësia për Përmbajtjen në Internet. OSF, Maj 2011, fq. 13

30 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 5, Maj 2008, fq. 3

31 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 11, Maj 2008, fq. 4

32 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 11, Maj 2008, fq. 4

33 Mushkolaj, Imer. Këshilli Medial i Kosovës (KMSHK). Intervistë. 14 Shkurt 2017





Parimi i proporcionalitetit vlen për rregullën e kompensimit të shpifjes dhe fyerjes. Për secilën deklaratë shpifëse ose përlënë, "kompensimi duhet të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar dhe duhet t'i jepet vetëm me qëllim të korigjimit të dëmit që i është shkaktuar reputacionit të personit ose të kompensohet ndonjë humbje financiare që mund të vërtetohet ose ndonjë dëm material."<sup>34</sup> Ligji gjithashtu njeh të drejtën e çdo zyrtari publik ose të kujtdo që është duke garuar për post publik të paraqes një kërkesë për kompensim të dëmit në mënyrë private dhe ekskluzive.

Kapitulli V i Ligjit mbi Shpifjen dhe Fyerjen i cakton obligimet e zvogëlimit të dëmit dhe të drejtën për tu kundërpërgjigjur në rastet e shpifjes dhe fyerjes. Personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkoj përmirësim të deklaratës nga publikuesi i cili gjoja se ka shkaktuar dëmin.<sup>35</sup> Ky veprim mund të përfshij (a) paraqitjen e kërkesës tek autoritetet rregulluese, që do të thotë KPM për audio dhe televizion dhe KMSHK për shtypin duke përfshirë lajmet online, dhe (b) kërkesën për përmirësim të deklaratës së bërë nga botuesi i cili gjoja se ka shkaktuar dëm. Parimi i të drejtës për kundërpërgjigje është një dispozitë e rëndësishme ligjore. Mund të ushtrohet nga gjithsecili dhe çdo medium, për qëllime të përmirësimit të fakteve që kanë të bëjnë me personin i cili është dëmtuar/poshtëruar nga një deklaratë.<sup>36</sup>

Ligji urdhëron që mediumi në fjalë duhet të bëjë publike kundërpërgjigjen për kërkesën e ankuesit. Disa përjashtime janë për këtë rregull në aspektin e refuzimit të përgjigjes ose të redaktimit të deklaratës duke u bazuar si në vijim<sup>37</sup>: (a) nëse kërkesa nuk adresohet brenda shtatë ditësh që nga dita kur ankuesi është vënë në dijeni për publikimin, (b) nëse gjatësia e kundërpërgjigjes tejkalon atë që është e nevojshme për të përmirësuar informatat e pasakta që pretendohen nga pala, (c) nëse kundërpërgjigja nuk është e kufizuar për përmirësimin e fakteve të kontestuar, (d) nëse kundërpërgjigja paraqet shkelje të dënueshme, (e) nëse konsiderohet të jetë kundër interesave të një pale të tretë të mbrojtura me ligj, dhe (f) nëse çështja individuale nuk mund të vërtetohet ekzistencën e interesit legjitim.

Disa kufizime të lirisë së shprehjes janë të përshkruara nga Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji Nr. 02/L-65). Nëse shpifja dhe fyerja përfshinë

34 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 5, Maj 2008, fq. 3

35 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 12 Maj 2008, fq. 5

36 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 13 Maj 2008, fq. 5

37 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 13 Maj 2008, fq. 5



një deklaratë të vërtetë dhe të arsyeshme me rëndësi për publikun, përjashtimet nga përgjegjësia dhe kufizimet janë të garantuara sipas Neneve 6, 7, dhe 8 të Ligjit<sup>38</sup> Ligji është i qartë dhe jo-retrospektiv – në përputhje me parimet e PNDPCP dhe KEDNj – kur është fjala për kufizimin e lirisë së shprehjes për qëllime të ruajtjes së të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve. Shpifja vlen vetëm për faktet dhe deklaratat që janë të vërteta<sup>39</sup>. Ajo gjithashtu i referohet opinioneve përderisa humori është një formë tjetër e shpifjes e cila nuk është e rregulluar me ligj. Vërtetimi i vërtetësisë të një pretendimi duhet të jetë një mbrojtje absolute në një padi shpifëse siç është e rregulluar me KEDNj dhe legjislacionin e vendit.

Ligji vendos se “i pandehuri [jo paditësi] duhet ta bart barrën e vërtetimit [parimi i barrës së provës] të vërtetësisë së deklaratës së kundërshtuar.”<sup>40</sup> Në çështjet e shqetësimit publik, i pandehuri duhet të vërtetoj se ai/ajo është sjellë me përgjegjësi, përveç nëse ai ose ajo e kanë ditur që deklarata është false ose kanë vepruar me mosrespektim të pamatur në lidhje me vërtetësinë e saj. Por çka nëse deklarata është e pavërtetë? Në rastin e Kosovës, në praktikë, një deklaratë shpifëse nuk sanksionohet edhe nëse nuk është plotësisht e saktë. Në ligj, neni mbi botimin e arsyeshëm mbron idenë që autori ka ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të publikuar një deklaratë në mirëbesim, vetëm nëse merr parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështjet me interes publik për të marrë informata në kohën e duhur në lidhje me çështje të tilla.<sup>41</sup> KEDNj i referohet parimit të interesit publik kur i peshon kufizimet në lirinë e shprehjes – shpesh duke e cituar rëndësinë e rolit të mediave në kontributin për bërjen e shoqërisë demokratike.<sup>42</sup>

## Struktura institucionale

Korniza institucionale në lidhje me mediat digjitale përbëhet nga rregullatori shtetëror siç është Komisioni i Pavarur për Media (KPM), institucionet vet-rregulluese (d.m.th, Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës), dhe Asociacioni i Pavarur i Mediave Elektronike në Kosovë (e njohur si AMPEK). Përveç mekanizmave që lidhen me mediat ka institucione që janë përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtës për liri të

38 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 6-8 Maj 2008, fq. 3

39 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 3 Maj 2008, fq. 2

40 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 6 Maj 2008, fq. 3

41 Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes Neni 7 Maj 2008, fq. 3

42 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNj), Neni 10, fq 11



shprehjes dhe privatësisë duke përfshirë Ombudspersonin, Agjencinë Kombëtare për Mbrojtje të të Dhënave, dhe gjyqësori.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) definohet sipas Kushtetutës (Neni 141) dhe Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media. KPM-ja si një institucion i pavarur që është përgjegjës për “rregullimin, menaxhimin, dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave transmetuese”.<sup>43</sup> KPM ka shtatë (7) Anëtar të Bordit të cilët caktohen direkt nga Parlamenti, tek i cili KPM-ja raportin në baza vjetore<sup>44</sup>. Në total, janë 186 transmetues të licencuar (d.m.th 20 stacione televizive, 78 radio stacione, 34 operator kabllor, dhe 54 ofrues të shërbimeve të programeve)<sup>45</sup>. Tre stacionet më të shikuara janë Radio Televizioni publik i Kosovës (RTK), televizioni privat Kohavision (KTV), dhe kabllori TV Klan.

KMSHK ose Këshilli i Mediave funksionon si vet-rregullues dhe organizatë jofitimprurëse që nga viti 2005 dhe është përgjegjës për rregullimin e shtypit të shkruar dhe online (respektivisht portaleve online). Për dallim nga KPM, KMSHK-ja nuk ka fuqi licencuese, nuk është i rregulluar nga shteti, dhe nuk merr fonde nga shteti. Është organizatë e bazuar në anëtarësi e përberë nga kryeredaktorët që përfaqësojnë në total 27 medime.<sup>46</sup> Në Kosovë, nuk ka norma ligjore për rregullimin e performancës të gazetarëve, dhe as nuk u lëshohet leje pune gazetarëve.

Disa nga medimet më të njohura dhe më të vizituara janë Indskonline, Gazeta Express, Telegrafi, Kallxo.com, dhe Koha Ditore<sup>47</sup>. Në një masë të madhe, këto janë media digjitale që frekuentohen përmes platformave të shumta sociale. Thuhet, sipas Alexa Internet, Inc, një kompani e cila ofron të dhëna ueb trafiku komerciale dhe analitike, rreth 9 deri në 11% e njerëzve vizitojnë Facebook-un dhe 4 deri në 6% e vizitojnë YouTube menjëherë para se të vizitojnë portalin kryesor online.

Disa grupe të anëtarësisë gjithashtu luajnë një rol në industrinë e mediave. Dy grupet kryesore janë Asociacioni i Gazetareve të Kosovës (AGK), dhe Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike (e njohur si AMPEK). AGK-ja është organizata më e madhe dhe më aktive me bazë në anëtarësi që përfaqëson interesat e gazetarëve në vend dhe avokon për çështjet e lirisë së medias. Gazetarët mund t'i bashkohen AGK-së në baza vullnetare.

43 KPM, Rregulli 12/1 mbi Rregullat dhe Procedurat e Komisionit të Pavarur për Media , 18 Shtator 2012, fq. 2

44 KPM, Rregulli 12/1 mbi Rregullat dhe Procedurat e Komisionit të Pavarur për Media , 18 Shtator 2012, fq. 3

45 Komisioni i Pavarur për Media (KPM), Raporti Vjetor 2014, Mars 2015

46 KMSHK <http://presscouncil-ks.org/members/> (e qasur me 11 Shkurt 2017)

47 Këshilli i Mediave të Kosovës (KMSHK), Anëtarët, <http://presscouncil-ks.org/members/> (e qasur me 19 Shkurt)

Anëtarët e AGK-së nuk marrin ndonjë benefit nga AGK-ja në kuptimin e sigurisë sociale. Nuk u ofron mbështetje financiare anëtarëve, për shembull, nëse ata humbin punën e tyre.

AGK njihet për promovimin e të drejtës dhe profesionit të gazetarit në gjithë vendin. AGK shpërndan çmime vjetore për gazetarët të cilët performojnë më së miri në fusha të ndryshme të medias. Në Qershor 2016, AGK u bë anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG) që është njëra nga sindikatat më të mëdha në botë që ka për qëllim të forcoj të drejtat dhe liritë e gazetarëve.<sup>48</sup>

Në anën tjetër, AMPEK-u funksionon si OJQ dhe përfaqëson interesat e 83 transmetuesve komercial në vend (duke përfshirë transmetuesit televiziv dhe të radios),<sup>49</sup> që përbejnë përafërsisht 70% të mediave elektronike në vend<sup>50</sup>. Përveç tarifave të anëtarësisë, AMPEK gjithashtu merr fonde nga jashtë.<sup>51</sup> AMPEK kryesisht është e përfshirë në draftimin e legjislacioneve që lidhen me sektorin e mediave audio-vizuale dhe avokimin për çështjet e lirisë së mediave në përgjithësi.

Në Kosovë, ka mjaftueshëm dispozita ligjore për të garantuar që mediat digjitale të japin përgjegjësi për veprimet e tyre. Megjithatë, shteti nuk ka shtrirë rregullore të tipit të transmetuesve tek mediat online dhe digjitale siç është rasti me shumicën e vendeve të zhvilluara. Rregullatorët e mediave i kanë Kodet e tyre të Etikës/Sjelljes të cilat përbëhen nga një set udhëzimesh se si mediat digjitale duhet të respektojnë disa të drejta kur është fjala për privatësinë dhe reputacionin e individëve (p.sh mbrojtja e identitetit të fëmijëve). Si Komisioni i Mediave, ashtu edhe Këshilli i Mediave duhet të garantojnë që organizatat e mediave nuk dështojnë t'i binden Kodeve të Sjelljes. Kodet thonë se secili ka të drejtën e privatësisë dhe redaktorët duhet të ofrojnë arsye për ndërhyrje në privatësinë e një personi në emër të interesit publik.

Pjese e rolit të KPM-së është të raportoj çdo shkelje dhe të vlerësoj ankesat nga palët e treta. KPM-ja ose Komisioni i Mediave inicion, pranon, dhe hulumton ankesat në mënyrë që të garantoj se operatorët e mediave audio-vizuale nuk do të dështojnë të jenë në pajtim me kushtet e licencës, kodit të sjelljes dhe akteve të tjera ligjore.<sup>52</sup> KPM-ja ose inicion ankesat ex-officio ose pranon ankesat nga palët e treta. Faktet preliminare

48 Ministria e Punëve të Jashtme, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Gazetarëve (<http://ëëë.mfa-ks.net/?page=1,216,3498>), Qershor 2016

49 Zejnullahu, Ardita. Asociacioni i Pavarur i Transmetuesve Medial në Kosovë (APTM). intervistë. 23 Mars 2017

50 UNESCO, Asociacionet dhe Sindikatat në Kosovë, (E qasur me 8 Prill 2017)

51 IREX, Qëndrueshmëria e Mediave në Kosovë, 2016, fq. 76

52 Gazeta Zyrtare Ligji No. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media, Prill 2012, Neni 29. Fq. 15



të marra nga KPM-ja fillimisht rishikohen për të përcaktuar nëse ligjet dhe kushtet janë shkelur. Me kompletim të hulumtimit, ajo lëshon një vendim duke i dhënë konsideratë të gjitha fakteve dhe rrethanave të rastit relevant.<sup>53</sup> Për secilën shkelje, KPM-ja jep vërejtje me shkrim dhe/ose merr një tarifë financiare.

Për më tepër, nëse KPM-ja konstaton se rregullorja është shkelur, do të kërkojë një korigjim ose pajtim me të cilin pajtohen si mediat, ashtu edhe personin ose organizatën që e ka shtruar ankesën, pa nevojë të sanksioneve formale. Korigjimet e mundshme përfshijnë: (a) një qartësim për përmirësim nga media, (b) e drejta e kundërpërgjigjes i jepet qytetarit, dhe (c) një kërkim falje publike nga media.<sup>54</sup> KPM në përgjithësi jep vërejtje, dhe në rast se shkelja është serioze, ajo vendos dënime. Cilësia dhe rreptësia e vendimeve të KPM-së në licencime është kritikuar shumë.<sup>55</sup>

Përveç kësaj, KPM-ja garanton mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga programet me përmbajtje të dëmshme.<sup>56</sup> Përmbajtja e dëmshme për fëmijët dhe të miturit gjithashtu rregullohet në pajtim me rregulloren, e cila e përkufizon si diçka që ndikon negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mendor, ose moral, ose e zbulon identitetin e tyre.<sup>57</sup> Asnjë program nuk duhet të lejohet të “publikoj informacione që zbulojnë identitetin e një fëmije deri në moshën 18 vjeçare i cili është përfshirë në çfarëdo rasti të çfarëdo lloji të dhunës, pa marrë parasysh statusit të fëmijës si dëshmitar, viktimë, ose autor krimi, ose në rast të tentimit të vetëvrasjes ose vetëvrasjes, si dhe prezantimi i detajeve të çështjeve familjare të fëmijës dhe jetës së tij private.”<sup>58</sup>

Roli kryesor i KMSHK-së është të avokoj për lirinë e shprehjes dhe të garantojë përputhshmëri me parimet e kodit të sjelljes i cili është amendementuar në vitin 2010 dhe është përditësuar për t’iu përshtatur nevojave dhe standardeve etike të portaleve online. Në fakt, forca morale pas Këshillit të Mediave është të garantojë media të përgjegjshme. Kodi i Sjelljes së Mediave e njeh shpifjen si akt në Nenin III. E ka përmbajtjen

53 Gazeta Zyrtare Ligji No. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media, Prill 2012, Neni 29. Fq. 15

54 Komisioni i Pavarur për Media (KPM), <http://ëëë.kpm-ks.org/?faqe=309&gjuha=3> (E qasur me 10 Shkurt)

55 Kosovo 2.0, COHU & PCK Liria e Shprehjes, Mediat dhe Informacioni në Kosovë, Maj 2016, fq. 31.

56 KPM, Kodi i Etikës I Ofruesve të Shërbimeve Mediale, Tetor 2016, fq. 31

57 KPM, Rregullorja mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet e Mediave Audio-Vizuale, Maj 2013, Neni 1, fq. 1

58 KPM, Rregullorja mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet e Mediave Audio-Vizuale, Maj 2013, Neni 4, fq. 3

e njëjtë si kodi i KPM-së. Ai i dekurajon mediat e shkruara dhe online që të nxisin krim përmes publikimit të informatave që janë poshtëruese për ndonjë individ ose grup duke u bazuar në kombësi, religjion, orientim seksual, gjini, racë, status martesor, moshë, ose paaftësi fizike.<sup>59</sup> Ka edhe dispozita tjera të rregulluara në bazë të kodit kur është fjala për shpifjen dhe fyerjen, që përfshinë të drejtën për t'u kundërpërgjigjur, mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve, dhe të drejtën për privatësi.<sup>60</sup>

Çka është më me rëndësi, Kodi i Sjelljes i KMSHK-së adreson çështjen e privatësisë, duke e njohur atë si një të drejtë të padhunueshme njerëzore e cila nuk varet nga rrethanat dhe personat me të cilët ka lidhje. Njëkohësisht, mediave u kërkohet të “shmangin ndërhyrjet dhe kërkimet në jetët private të njerëzve, përveç nëse një ndërhyrje e tillë ose kërkim është i domosdoshëm për shkak të interesit të publikut.”<sup>61</sup> Mbrojtja e fëmijës dhe të miturve gjithashtu mbrohet nga Kodi i Sjelljes. Gazetarët nuk duhet të intervistojnë ose fotografojnë fëmijë nën moshën 18 vjeçare për çështje që përfshinë familjen e fëmijës pa pajtueshmërinë e një prindi ose të një të rrituri që është përgjegjës për fëmijën. Ata gjithashtu “nuk duhet të identifikojnë fëmijët nën moshën 18 vjeçare që janë të përfshirë në raste penale si viktimë, dëshmitar, ose të pandehur.”<sup>62</sup>

Një nga funksionet më të rëndësishme të Këshillit të Mediave është të administroj ankesat në lidhje me shpifjet dhe deklaratat fyese të bëra nga palët e treta. Ajo vendos për masat që duhet marrë nëse ankesa konsiderohet e vlefshme.<sup>63</sup> Ankesat bëhen brenda një muaji nga data e publikimit të përmbajtjes e cila pastaj rishikohet dhe vlerësohet nëse bie në fushëveprimin e përgjegjësive të KMSHK-së.<sup>64</sup> Këshilli i Mediave pranon ankesa të paraqitura kundër anëtarëve dhe jo-anëtarëve për të cilët pastaj ai jep opinione [jo dënime] siç përcaktohet në Rregullat e Procedurës.<sup>65</sup> Nëse kërkesa është e pranueshme për këshillin e mediave për ta adresuar, bëhen përpjekje për të bërë një ujdi dhe për të zgjidhur kontestimet mes palëve brenda një muaji që nga fillimi i procedurës. Së fundi, rasti i referohet bordit për vendimin përfundimtar që duhet të merret brenda një periudhe prej tre muajsh që nga pranimi i ankesës.<sup>66</sup>

59 KMSHK, Kodi i Sjelljes së Mediave, Nuk ka datë, Neni 3, fq. 3

60 KMSHK, Kodi i Sjelljes së Mediave, Nuk ka datë, Neni 4-7, fq. 3-4

61 KMSHK, Kodi i Sjelljes së Mediave, Nuk ka datë, Neni 7, fq. 4

62 KMSHK, Kodi i Sjelljes së Mediave, Nuk ka datë, Neni 6, fq. 4


63 KMSHK, Kodi i Sjelljes së Mediave, Nuk ka datë, Neni 3, fq. 2

64 Speller, Catherine, Një Vlerësim i Nevojave të Këshillave të Mediave në Evropën Jug-Lindore, Qershor 2015, fq.

20

65 KMSHK, Kodi i Sjelljes së Mediave, Nuk ka datë, Neni 4, fq. 3

66 Speller, Catherine, Një Vlerësim i Nevojave të Këshillave të Mediave në Evropën Jug-Lindore, Qershor 2015, fq. 20



## Gjetjet e hulumtimit

Gjetjet kryesore të këtij studimi tregojnë se autoritetet rregullatorë të mediave dhe institucionet gjyqësore dështojnë në definimin e baraspeshës mes të drejtës për liri të shprehjes dhe të drejtës për privatësi/reputacion. Theks i veçantë vihet në shpifje dhe fyerje për të parë se si mediat i zbatojnë rregullat sa i përket përdorimit të përmbajtjes shpifëse ndaj individëve. Projekti mundi të marr shumë pak informacione institucioneve gjyqësore për t'i ekzaminuar më afër masat e llogaridhënies të vendosura ndaj mediave digjitale që sillen keq. Për shembull, nuk ka asnjë vendim të gjykatës ose përfaqësim nga avokatët të raportuar për rastet e shpifjes përkundër një numri të kërkesave që janë bërë tek to.

## Llogaridhënia institucionale

Qeveria ka tendencë të llogaris në autoritetet rregullatorë të mediave për të rregulluar përmbajtjen online me qëllim të mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe të drejtat tjera përkatëse të garantuara me Kushtetutë. Megjithatë, deri më tani, mediat tradicionale - si të shkruara ashtu edhe transmetuese - nuk janë përshtatur shfaqjes së mediave online. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se autoritetet rregullatorë të mediave janë shumë jo-efikase dhe të anshme në ushtrimin e rrolit të tyre rregullator. I njëjti pretendim është raportuar në shumë studime duke përfshirë një të bërë së voni nga Kosovo 2.0, Çohu, dhe KMSHK-ja në vitin 2016.

Këto autoritete rregullatore kanë mungesë të pavarësisë institucionale dhe burimet për t'i identifikuar termat që tërheqin përmbajtje shpifëse dhe t'i mbajnë përgjegjëse mediat që e bëjnë këtë. KPM-ja dhe mediat publike janë në pozita më të mira financiare në krahasim me KMSHK-në, edhe pse ata përballen me shkurtime buxhetore çdo vit. KMSHK-ja dhe mediat online udhëhiqen si entitete private dhe shumica prej tyre duhet të llogarisin në përkrahje nga bizneset në formë të reklamave. Duke pasur parasysh dallimet e strukturave institucionale, Komisioni shihet si më i anshëm politikisht, përderisa Këshilli i Mediave më shumë i varur nga sektori privat.

Në Kosovë, mediat digjitale nuk mbahen mjaftueshëm përgjegjëse nga institucionet përkatëse. Komisioni i Mediave nuk është efikas në ushtrimin e rolit të tij sepse ai varet shumë në vendimmarrjen politike. Ai është kritikuar shpesh për jo-konsistencë në sanksionimin e vendimeve të tyre përfundimtare, kryesisht për shkak të presioneve politike që vinin nga jashtë.<sup>67</sup> KPM-ja është e predispozuar për ndikime politike sepse Anëtarët e Bordit emërohen drejtpërdrejt nga Kuvendi.<sup>68</sup> Mënyra e zgjedhjes dhe emërimit të bordit të KPM-së është kritikuar në të kaluarën, në lidhje me një numër të konflikteve të interesit dhe incidente të dorëheqjes për shkak të ndërhyrjes dhe vonesave në emërimin e anëtareve të rinj. Është raportuar në Raportin e Progresit të KE-së (2014) se emërimet e KPM-së “favorizonin lidhjet politike në vend të pavarësisë”.<sup>69</sup> Me vite Komisioni ka pasur probleme të konsolidoj bordin, gjë që ka shkaktuar vonesa në një numër çështjesh (p.sh digjitalizimi i transmetuesve analog).

Në Kosovë, përpjekjet për të vetë-rregulluar industrinë e mediave kanë qenë të hapura, ku mbështetja e komunitetit ndërkombëtar ka qenë vendimtare në vendosjen e rregullave dhe institucionet që do të përkrahnin kauzën. Për shembull, Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës (KMSHK) është themeluar në vitin 2005 me përkrahjen teknike dhe ndërkombëtare të komunitetit ndërkombëtar pas adaptimit të Kodit të Shtypit.<sup>70</sup> Anëtarësia e saj përbehet nga media të cilat janë të varura financiarisht nga sektori privat. Tani që ka më pak financime nga komuniteti ndërkombëtar, media digjitale kanë tendencë të varen më shumë në sektorin privat për përfitime nga reklamat (mediat publike kanë një përparësi pasi përafërsisht 80% e buxhetit të tyre është i financuar nga shteti).<sup>71</sup>

Rrjedhimisht, komuniteti i biznesit ushtron kontroll enorm dhe përmes korrupsionit ndikon në lajmet për interesa të veta. Është vështirë të konceptohet ndikimi i bizneseve në mediat digjitale pasi deklaratimet e tyre financiare nuk janë publike. Kjo është posaçërisht më problematike kur flasim për mediat digjitale që kritikohet shumë për mungesë të transparencës financiare.<sup>72</sup> Mediat digjitale ose portalet online janë të regjistruara si biznese private më Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Ato nuk raportojnë tek asnjë

67 Sutaj, Visar & Artan Canhasi. Vlerësimi i Sistemit Kombëtar të Integritetit – Kosovë. KDI. Tetor 2015, fq. 192.

68 Kosovo 2.0, COHU & PCK Liria e Shprehjes, Mediat dhe Informacioni në Kosovë, Maj 2016, fq. 30.

69 Komisioni Evropian (KE), Raporti i Progresit për Kosovën, Tetor 2014, fq. 17.

70 White, Aidan. Faktori i Besimit. Ethical Journalism Network. 2016, fq. 2

71 International Research & Exchange Board (IREX). Indeksi I Qëndrueshmërisë së Mediave në Kosovë. 2016, fq. 75-76.

72 International Research & Exchange Board (IREX). Indeksi I Qëndrueshmërisë së Mediave në Kosovë. 2016, fq. 71-





institucion me përjashtim të autoriteteve tatimore për tatim mbi të ardhurat dhe tek Këshilli i Mediave (nëse janë anëtar vullnetar).

Përvoja e autoriteteve rregullatorë në rregullimin e mediave digjitale nuk ka qenë efikase. Për më tepër duke pasur probleme të brendshme menaxhimi, KPM-ja dhe KMSHK-ja kanë mungesë të burimeve për të mbikëqyrur çfarë raportohet dhe çfarë potencialisht shkelet përmes përmbajtjes online. Kjo është e një rëndësie të veçantë duke parë që kompanitë e internetit, të cilat po ashtu luajnë një rol vetë-rregullues kur është fjala për përmbajtje të dëmshme, nuk mund të filtrojnë përmbajtjen e dëmshme për shkak të barrierave ose kufizimeve të përkthimeve të përmbajtjes nga Shqipja ose Serbishtja në Anglisht.

Komisioni i Mediave nuk ka qenë proaktiv në trajtimin e rastet e shpifjes, kryesisht për shkak të numrit të vogël të zyrtarëve mbikëqyrës. Nga 2010-2016, KPM-ja ka pranuar në total 45 raste të ankesave për shpifje. Kodi përcakton çfarë konsiston përmbajtja e dëmshme ose poshtëruese – nga secili material që nxit aktivitete kriminale dhe kërcënime të përgjithshme për individët dhe pronën tek materiali që është shpifës, diskriminues dhe fyes për dinjitetin njerëzor.<sup>73</sup> Në vitin 2016, nëntë ankesa u paraqiten tek KPM-ja për shkelje të kodit të etikës së ofruesve të shërbimeve mediale.<sup>74</sup> Ankesat lidheshin me kërcënime mediale për integritetin territorial dhe personal, keqinterpretim i deklaratave, publikim i teksteve ose videove denigruese, dhe deklarata diskriminuese të bëra ndaj disa komuniteteve pakicë. Tri (3) ankesa ishin adresuar tek mediumi Klan Kosova, ndërsa për tri mediumet tjera – RTK, KTV, TV Dukagjini – janë paraqitur dy (2) ankesa për medium tek KPM-ja.

Me ligj, Komisionit të Mediave nuk i kërkohet në mënyrë specifike t'i mbikëqyrë shtypin online. Por pasi gazetarët e mediave digjitale në ditët e sotshme punojnë me video, audio dhe internet në mënyrë simultane, do të ishte e udhës që Komisioni për Media të punonte më afër me Këshillin e Mediave në adresimin e ankesave të palëve të treta kur është fjala për shpifje dhe fyerje. Megjithatë, kjo deri më tash nuk ka ndodhur.<sup>75</sup> Komisioni i Mediave nuk ka treguar mbështetje të mjaftueshme ose gatishmëri në ushtrimin e përgjegjësisë së vet morale t'i ndihmoj këshillit medial që t'i adresoj rastet e shpifjes që bien në fushëveprimin e saj të

72.

73 KPM. Kodi i Etikës i Ofruesve të Shërbimeve Mediale. Tetor 2016, Neni 3, fq. 2

74 Informacion i marrë nga KPM-ja përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, 9 Shkurt 2017

75 Mushkolaj, Imer. Këshilli i Mediave të Kosovës (KMSHK). Intervistë. 14 Shkurt, 2017



punës me përmbajtje audio dhe vizuale. KPM-ja në fakt zgjedh të shmang sa më shumë përgjegjësinë që është e mundur. Megjithatë, Komisioni i Mediave në lidhje me rregulloret e aplikueshme që kanë të bëjnë me reklamat dhe mbrojtjen e të miturve kanë qenë shumë më efikas në mbikëqyrjen e përmbajtjes së mediave duke dërguar vërejtje edhe pse nuk ka qenë aq e ashpër në dhënien e dënimeve.

Këshilli i Mediave ka qene jo-efikas si organizatë vetë-rregulluese në disiplinimin dhe përmirësimin e sjelljes së papërgjegjshme të mediave digjitale rreth angazhimit të tyre në gjuhë shpifëse dhe fyese. Për dallim nga Komisioni për Media, këshilli i Mediave nuk ka autoritet për licencim dhe dënime për të rregulluar mediat që e pengojnë atë për tu bërë një trup i fuqishëm për censurë. Nuk ka ndonjë normë ligjore që rregullon performancën e gazetareve. Prandaj, këshilli si një organizatë jofitimprurëse nuk ka një autoritet të fuqishëm ligjor për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve që mund të jenë cenuar nga një burim tjetër i mediave. Në total, këshilli i mediave administron 55 deri në 65 ankesa në baza vjetore.<sup>76</sup> Këto ankesa rishikohen dhe rekomandohen tek bordi nga një këshilltar ligjor.<sup>77</sup> Këshilltari gjithashtu asiston, nëse është e nevojshme, palët e treta në gjykata, por të cilat dështojnë t'i përmbahen gjykimit pothuajse në të gjitha rastet.<sup>78</sup>

Në vitin 2016, 47 vendime u morën për ankesat e adresuara tek KMSHK-ja. Nëntë (9) nga këto vendime ishin të lidhura me shpifjet dhe fyerjet (Kapitulli II i kodit).<sup>79</sup> Këto janë raste të shpifjes dhe fyerjes të adresuara tek anëtarët e KMSHK-së. Këshilli i Mediave gjithashtu administron ankesat e adresuara tek mediumet të cilat nuk janë anëtare të këshillit.<sup>80</sup> Në total, 20 vendime lidhe me sjelljen e papërgjegjshme nga mediat jo-anëtare të KMSHK-së.<sup>81</sup> Në thelb, KMSHK-ja nuk është efi-kase sepse është e kufizuar për shkak të natyrës së operimit të saj. Jo vetëm që është e privuar nga fuqitë licencuese por ajo gjithashtu nuk ka një njësi mbikëqyrëse për të mbikëqyrrur performancën e anëtarëve të vet sikurse që e ka KPM-ja.<sup>82</sup> Për më tepër, vendimet nuk janë përdorur në mënyrë efi-kase nga gjykatat për shkak mungesës interesit dhe ekspertizës për të zgjidhur rastet e shpifjes.

76 Mushkolaj, Imer. Këshilli i Mediave të Kosovës (KMSHK). Intervistë. 14 Shkurt, 2017

77 Mushkolaj, Imer. Këshilli i Mediave të Kosovës (KMSHK). Intervistë. 14 Shkurt, 2017

78 Gashi, Krenar. [Vendet në transit 2015](#). Freedom House. Qershor 2016, fq. 331

79 Informacion i marrë nga KPM-ja përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, 9 Shkurt 2017

80 Mushkolaj, Imer. Këshilli i Mediave të Kosovës (KMSHK). Intervistë. 14 Shkurt, 2017

81 Informacion i marrë nga KPM-ja përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, 9 Shkurt 2017

82 Mushkolaj, Imer. Këshilli i Mediave të Kosovës (KMSHK). Intervistë. 14 Shkurt, 2017



Në Kosovë, shteti nuk kërkon të bllokoj ose filtroj përmbajtjen në internet e cila vlerësohet si e dëmshme. Në vend të kësaj, përveç që mbështetet në institucionet rregulluese të mediave siç janë KPM-ja dhe KMSHK-ja, shteti mbështetet edhe në kompanitë e internetit, siç janë ofruesit e shërbimeve host, makinave kërkuese dhe rrjeteve sociale, për të filtruar përmbajtjen e dëmshme. Sipas politikave të shumicës së këtyre makinave të internetit, ata janë të detyruar të heqin përmbajtjen në mënyrë vullnetare nëse u jepet një urdhër i vlefshëm i gjykatës që e ka cilësuar përmbajtjen si shpifëse. Ofruesit kryesor të internetit (OSHP-të) në Kosovë janë IPKO dhe Kujtesa që mbulojnë gati 50-50 përqind ofrim të internetit (edhe pse IPKO është duke bërë më shumë progres në aspektin e zgjerimit të mbulueshmerisë në katër vitet e fundit).

OSHP-të obligohen me ligjet ekzistuese vendore dhe veprojnë si ndërmjetësues të internetit ku mund të drejtohen ankesat për të hequr përmbajtjen e dëmshme. Nuk është e qartë në çfarë mase OSHP-të posedojnë aftësitë teknike për të kryer filtrimin e caktuar të përmbajtjes dhe ueb faqeve. Përkundër faktit që një numër kërkesash janë bërë tek IPKO dhe Kujtesa rreth numrit të kërkesave të bëra për heqje të përmbajtjes, nuk është raportuar për filtrim mbarëkombëtar deri më tani. Nuk janë publikuar për përdoruesit në ueb faqet zyrtare të asnjërës nga OSHP-të online udhëzime të cilat tregojnë se cila përmbajtje konsiderohet shkelje e privatësisë ose reputacionit, dhe rrjedhimisht cilat përmbajtje mund të hiqen. As mediat digjitale nuk kanë një set udhëzimesh për heqjen e informacioneve shpifëse për ueb faqet, në mënyrë që të presin që përdoruesit e tyre të veprojnë në përputhje me to kur të postojnë përmbajtje.

Për të pasur mundësi të heqim diçka vullnetarisht (pa urdhër të gjykatës), për shembull, nga rezultatet e kërkimit në Google, përmbajtja fillimisht duhet të hiqet nga burimi origjinal. Rrjedhimisht, përfundimisht varet se sa bindshëm argumenton një individ ose sa arsye të fortë ka të detyroj ose bind një ueb faqe për të hequr përmbajtje. Kur një përmbajtje hiqet, Google dhe makinat tjera kërkuese do ta filtrojnë nga rezultatet e kërkimit. Por, nëse për çfarëdo arsye rezultati i kërkimit ende reflekton përmbajtjen e vjetër. Google URL Removal Tool (Mjeti për heqjen e URL-ve) mund të përdoret për ta rregulluar atë. Ose autori i informatës shpifëse mund të konfrontohet me kërcënim me veprim ligjor për ta larguar informacionin vullnetarisht (duke supozuar që ueb faqja e lejon autorin ta heq përmbajtjen).

Por çfarë ndodh nëse autori i informacionit shpifës të postuar në një ueb faqe nuk mund ta largojë përmbajtjen dhe ueb faqja nuk është e gatshme ta heq atë me vetë-dëshirë? Në këtë rast, nëse një urdhër i vlefshëm i gjykatës nuk mund të merret, ueb faqet dhe makinat e internetit kanë të drejtë të refuzojnë kërkesën për heqje. Padiësi ose pala reputacioni i së cilës është dëmtuar padit individin që ka autorizuar informacionin dhe merr një vendim të gjykatës që e deklaron përmbajtjen të paligjshme. Ky vendim i gjykatës prezantohet tek ueb faqja ose edhe tek makinat kërkuese siç është Google. Kjo mund të jetë më e komplikuar nëse identiteti i autorit është anonim, me ç ‘rast përpjekje të mëtutjeshme kujdesit të duhur duhet të aranzhohen për të zbuluar identitetin.

Me ligj, host kompanitë dhe ueb faqet nuk janë të obliguara me ligj të largojnë përmbajtje shpifëse pa urdhër të gjykatës. Pa vendimin e gjykatës në favor të largimit të përmbajtjes së dëmshme, do të ishte e pamundur për ueb faqet dhe host kompanitë të menaxhojnë mijëra pretendime për shpifje. Përderisa Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes nuk cakton ndonjë rregull për heqjen e përmbajtjes, është në përgjegjësinë e gjyqtarit ta bëjë këtë për t’iu përshtatur rrethanave unike të rastit. Sa i përket të drejtës për privatësi, në rastin e mediave sociale, siç janë Facebook-u dhe Twitter, të gjitha faqet e kanë opsionin e rregullimeve për të mundësuar kontrollimin se kush mund të ketë qasje në informatat personale, edhe pse kjo nuk garanton mbrojtje të plotë pasi janë të hapura për publikun. Për më tepër, ata shpesh përgjigjen shume ngadalë për heqjen e përmbajtjes në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Kompanitë ndërkombëtare të internetit, rregullisht bëjnë kërkesa nga gjykatat dhe institucionet qeveritare për të hequr përmbajtje nga produktet e tyre, nëse i shkel ligjet dhe politikat kombëtare të korporatave. Raportet e transparencës të lëshuara nga këto kompani të cilat paraqesin statistika mbi kërkesat të dhënave, dokumentet, ose përmbajtje të përdoruesve tregojnë fushëveprimin dhe autoritetin e rregullimit të përmbajtjes për mediat online. (Google ka qenë kompania e parë e internetit e cila ka publikuar Raportin e Transparencës në vitin 2010 duke përfshirë të dhëna mbi numrin e kërkesave të qeverive për kufizime dhe largime të përmbajtjes).<sup>83</sup> Në rastin e Kosovës, agjencitë për zbatimin e ligjit kanë kërkuar dy herë nga Google që të hiqen video nga YouTube.<sup>84</sup> Kërkesa e fundit e bërë në vitin 2013 kishte të bënte me dy video ku shihen të

83 MacKinnon, Rebecca, Elonnai Hickok, Allon Bar, and Hae-in Lim. Kujdesi për lirinë online. UNESCO. 2014, fq. 123

84 Raporti i Transparencës i Google. Kosova. [Qasur me 9 Prill, 2017]



mitur duke u përleshur të cilat u hoqën për shkak se shkelnin udhëzimet e komunitetit të Google. Megjithatë, kërkesa tjetër që u bë në vitin 2012 që kishte të bënte me kinse shkeljen e privatësisë të politikanëve nuk u hoqën. Rasti i fundit tregon që kompanitë e internetit mund të zgjedhin të mos binden ndaj kërkesave të qeverive për kufizime.

## Vendimet e gjyqësorit

Kur sistemet e rregullimit nuk funksionojnë në mënyrë efikase, është detyrë e zbatuesve të ligjit, posaçërisht e gjyqësorit, të siguroj që mediat e papërgjegjshme të mbahen përgjegjëse për ndonjë akt të sjelljes së keqe. Shkeljet civile në lidhje me shpifjen dhe fyerjen kryhen me anë të padive private. Kjo do të thotë që nëse një zyrtar publik beson se është fyer ose ka pasur shpifje ndaj tij nga një gazetar i mediave digjitale, ai mund të ngritë padi kundër shkelësit (medias digjitale/gazetarit) por zyra e prokurorit nuk mund të ndjek shkelësin ex-officio.

Megjithatë, në Kosovë, liria e shprehjes dhe e drejta e privatësisë paraqesin një sfidë serioze në komunitetin gjyqësor. Në Kosovë, juridiksioni i mediave është shumë tolerant ndaj lirisë së shprehjes në internet. Kosova nuk është një vend ku mediat mund të paditen lehtë për shpifje jo vetëm për shkak të rëndësisë që vendi, si një demokraci e re, i jep lirisë së shprehjes por edhe gjykatat dhe gjykatësit nuk janë të përgatitur ose të trajnuar mjaftueshëm për tu marrë me rastet e shpifjes. Por për dijeninë e publikut, ka mungesë të të dhënave mbi gjykatësit për rastet në lidhje me shpifjet dhe fyerjet.

Shpifja përfshinë rastet financiare dhe jo-financiare që kanë cak korrigjimin e demit të bërë nga deklarata shpifëse. Rastet jo-financiare kryhen më formë të kërkim faljes ose përmirësimit. Problemi është që korrigjimet e imponuara janë të lehta edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare në dispozicion për publikun mbi numrin e rasteve që kanë të bëjnë me administrimin e shpifjes dhe fyerjes në gjykata. Deri më tani, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) nuk ka ofruar ndonjë të dhënë mbi padite e ngritura civile për shpifje në gjykata sa i përket dëmshpërblimeve, dëmeve ose kërkim faljeve përkundër kërkesave të shumta që informacionet të bëhen.

Edhe Human Rights Watch (HRË) nuk mundi të dokumentonte padite civile për shpifje kundër gazetarëve në Kosovë.<sup>85</sup> Asociacioni i Gazetarëve

85 Human Rights Watch (HRË). Një profesion i vështirë: Liria e medias e sulmuar në Ballkanin perëndimor. 15 Korrik 2015

të Kosovës ka raportuar qe ka pasur 20 raste të padive për shpifje.<sup>86</sup> Megjithatë, AGK-ja nuk ka publikuar asnjë raport analizë që bazohet në monitorimin e rasteve të gjykatave kundër mediave digjitale ose gazetarëve të akuzuar për shpifje dhe fyerje. Sa i përket statistikave të përgjithshme që u morën, vetëm Ombudspersoni raporton në baza vjetore mbi numrin e rasteve që janë duke u hetuar për shkelje të të drejtave kushtetuese. Rrjedhimisht, vetëm dy raste të lidhura me lirinë e shprehjes janë hetuar në vitin 2016, ndërsa 19 raste kishin të bënin me privatësinë.<sup>87</sup> Megjithatë, statistikat janë të gjëra dhe nuk ofrojnë detaje nëse mediat digjitale kanë qenë subjekt i këtyre reasteve.

Gjykata obligohet me ligj të përkufizoj me ligj nëse përmirësimi, tërheqja, ose kërkim falja është mase e mjaftueshme për të kënaqur ankuesin.<sup>88</sup> Dëmet jo-financiare janë më problematike në gjyqësor. Kjo i referohet dëmshpërblimeve financiare që duhen të bëhen për të kompensuar humbjet të cilat nuk mund të kalkuloohen saktësisht në vlera monetare (p.sh humbja e reputacionit). Ndikimi i dënimeve ose dëmshpërblimi që shpesh bëhen ndaj mediave janë një arsye e fortë se pse gjyqësori frikësohet nga paditë për shpifje dhe fyerje. Këtij fenomeni i referohemi si efekti drithërues i cili definohet si çdo veprim ligjor i cili do të shkaktonte hezitim tek individët për të ushtruar të drejtën ligjore e tillë siç është liria e shprehjes duke u frikësuar nga pasojat ligjore<sup>89</sup>. Ky efekt i dekurajon gjykatësit të marrin vendime të cilat mund potencialisht ta shkelin lirinë e shprehjes. Në këtë rast, dënimet dhe/ose dëmshpërblimet janë çështje jo vetëm të mediave por gjithashtu edhe për kufizimet që Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes mund të paraqes për gazetarinë.

Gjykatat kombëtare duket se hezitojnë të gjykojnë raste që përfshijnë çështjet e lirisë së shprehjes, dhe dosjet e këtyre rasteve vetëm po rriten<sup>90</sup>. Ligji nuk është testuar si duhet nga gjykatat, përderisa shumë padi janë në pritje.<sup>91</sup> Është dëshmuar në shume studime hulumtuese që gjykatat nuk janë mjaftueshëm të arsimuara për tu marrë me ankesa që vijnë nga KPM-ja, KMSHK-ja ose direkt nga palët kur është fjala për shpifje dhe fyerje. Gjykatësve u mungon ekspertiza dhe vetëbesimi profesional në fushën e ligjit të mediave, dhe kështu, nuk janë të gatshëm të merren me

86 Collaku, Petrit. Indikatorët e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë. Dhjetor 2016, fq. 20  
87 Institucioni i Ombudsperson. [Raporti vjetor 2016](#). Prishtinë 2017, fq. 186  
88 Gaztea Zyrtare. Ligji Nr. 02/L-065 kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Neni 13. Maj 2008, fq. 6  
89 Fjalori Ligjor. <http://laë.yourdictionary.com/chilling-effect> [E qasur me 11 Shkurt 2017  
90 Gashi, Krenar. [Kombet në transit 2015](#). Freedom House. Qershor 2016, fq. 332  
91 Collaku, Petrit. Indikatorët e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë. Dhjetor 2016, fq. 6



këto raste që kanë të bëjnë me lirinë e medias dhe të shprehjes<sup>92</sup>. Gjetjet tregojnë se gjykatësit nuk janë trajnuar mjaftueshëm sa i përket Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ky nen ofron të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit.

Për pasojë, gjykatat nuk janë aq kompetente sa të baraspeshojnë mbrojtjen e lirisë së shprehjes me të drejtat tjera siç janë e drejta e privatësisë dhe reputacionit. Kjo është kundër parimeve të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, që kërkon që baraspesha të jetë në thelbin e të gjitha të drejtave, në masën më të madhe të mundshme. Nuk ka një precedent gjyqësor i cili mund të informoj një gjykatës si mund ose nuk mund të mbrohet interesi publik kundër shpifjes dhe fyerjes. Kjo e dekurajon publikun e gjere për të raportuar ndonjë deklaratë shpifëse ose fyese e bërë nga mediat dhe kështu të paraqesin pas, posaçërisht duke pasur parasysh se kostoja e ngritjes së në padie civile është e lartë dhe dekurajuese.<sup>93</sup>

Përkundër një numri të kërkesave të bëra tek Akademia e Drejtësisë (i njohur më parë si Instituti gjyqësor i Kosovës), i cili është përgjegjës për trajnimin dhe arsimimin e gjykatësve dhe prokurorëve, nuk ka pasur një përgjigje nga ta në lidhje me modulet e trajnimit mbi çështjet e të drejtave të njeriut në lidhje me shpifjen dhe fyerjen. Mbrojtja juridike në rastet e shpifjes dhe fyerjes është pjesë e Programit të Trajnimeve të Akademisë. Përmbajtja e këtij trajnimi përbëhet nga (a) mbrojtja e të drejtave të njeriut, (b) përgjegjësia dhe përjashtimi nga përgjegjësia, (c) kompensimi, dhe (d) afatet, mbrojtja e burimeve dhe gjykatat kompetente.<sup>94</sup> Megjithatë, nuk ka informacione mbi numrin e gjykatësve që kanë përfituar nga ky program dhe as nuk ka ndonjë vlerësim për ndikimin e trajnimit, që e bën të vështirë të kuptohet në çfarë mase gjykatësit janë të aftë të zbatojnë standardet dhe kërkesat në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Institucionet publike, në veçanti gjyqësori, nuk reagojnë mirë ndaj ankesave të qytetarëve kur është fjala për shkeljen e të drejtës së privatësisë dhe reputacionit. Niveli i zbatimit të ligjit mbetet problematik. Nuk ekzistojnë pasoja financiare nga padia për shpifje. Duke u bazuar në observimet në terren dhe intervistat, nuk ka ndonjë media digjitale në vend që ka paguar një gjobë të madhe për shkak të shpifjes. Rrjedhimisht, individët nuk janë të gatshëm të padisin në gjykata ku nuk ka gjasa për sukses. Një nga

92 International Research & Exchange Board (IREX). Indeks i stabilitetit të mediave në Kosovë. 2016, fq. 72

93 Nimoni, Genc. Çohu! Intervistë, 13 Shkurt 2017

94 Akademia e Drejtësisë. [Programi I trajnimeve](#). Ueb Faqja Zyrtare. [E qasur me 30 Prill 2017].



gjetjet kryesore tregon se derisa gjykatat në Kosovë rrallë kanë aplikuar ose i janë referuar praktikave të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut gjatë tentimit për të marrë një vendim.

Përveç tjerash, gjobat në rastet civile të shpifjes nuk synojnë as ta dënojnë shpifësin e as të korrigjojnë gabimin e shkaktuar ndaj personit për të cilin shpifet. Kosova në përgjithësi nuk është miqësore ndaj paditësve për shpifje, duke përfshirë edhe zyrtar të qeverise, siç është rasti në shume vende të Ballkanit Perëndimor ku zyrtarët publik dhe bizneset e fuqishme shpesh janë të lidhur me elitat politike, “tentimi për t’i shukurat mediat kritike dhe gazetarët duke i paditur ata vazhdimisht për shpifje.”<sup>95</sup> Në këto raste, shpifja shfrytëzohet për të cunguar të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mediave.

Në Kosovë, deri më tani, ka pasur shume raste të dështuara për t’i shukurat mediat kritike. Rasti më kontrovers përfshinte Adem Grabovcin, një ish Kryesues i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), parti politike në pushtet, i cili ngrii padi ndaj mediumit online “Insajderi” rreth publikimit të një serie të telefonatave të përgjuara për të cilat ai pretendonte se e cenonin privatësinë e tij dhe të drejtat kushtetuese. Këto biseda zbulonin afera korruptive të nivelit të lartë brenda qeverisë. Zoti Grabovci ka kërkuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës to lëshoj një urdhër të përkohshëm ndaj “Insajderit” që të mos vazhdoj publikimin e bisedave të rrjedhura duke pretenduar se është shkelur privatësia e tij.<sup>96</sup> Sipas ligjit kundër shpifjes, “një person ka të drejtë të kërkoj ndalimin e shpifjeve dhe fyerjeve dhe të kërkoj që të mos përsëritet në të ardhmen.”<sup>97</sup>

Megjithatë, gjykata themelore vendosi kundër paditësit, duke cituar se padia ishte e pabazë dhe kishte të bënte me shkelje të privatësisë. Gjykata refuzoi pretendimin për shkelje të privatësisë na bazë të asaj se “ai është një figurë publike dhe zbulimet ishin në interes të publikut.”<sup>98</sup> Në këtë rast, Gjykata Themelore e ka interpretuar të drejtën e privatësisë jo si të drejtë absolute, por si e drejtë e kufizuar për tu konsideruar në rrethana të veçanta. Interpretimi është në përputhje me kushtetutën, e cila thotë se “sekreti i korrespondencës, telefonata dhe komunikimet tjera janë të drejta të pacenueshme, të cilat mund të kufizohen përkohësisht nga

95 Human Rights Watch (HRË). Një profesion i vështirë: Liria e medias e sulmuar në Ballkanin perëndimor. 15 Korrik 2015

96 Insajderi. [Adem Grabovci humb betejën e tij të parë në gjyq kunder Insajderiti](#). 23 Gusht 2016. [E qasur me 19 Prill 2017]

97 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 02/L-065 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Neni 4, Maj 2008, fq. 2

98 Reporterët pa Kufi. Gjykata e apelit e Kosovës merr anën në kundërshtim të Ueb Faqes Investigative, Tetor 2016



një vendim i gjykatës nëse është e nevojshme për procedura penale ose mbrojtje të vendit siç përkufizohet me ligj.”<sup>99</sup>

Si do që të jetë, vendimi i gjykatës më të ulët u shfuqizua nga Këshilli i Apelit. Sipas organizatës jofitimprurëse për media, Reporterët pa Kufij (RPK), vendimi ka vënë një kërcënim për gazetarinë, mënyra se si Gjykata më e lartë ka marrë anën e paditësit duke i dhënë këshilla se si ta pares rastin e tij dhe t'i përmirësoj shanset e veta për ta fituar padinë. Me fjalët e Pauline Ades-Mevel, Kryesuesja e RPK për Evropë – Tavolina e Ballkanit, “Fakti se gjykatësit e Gjykatës së Apelit përkrahën një paditës [Z. Grabovci] vë dyshime besueshmërinë dhe pavarësinë e saj gjyqësore.”<sup>100</sup> Çka e bën këtë rast dhe mënyrën se si është menaxhuar ky rast kontrovers është një tregues i qartë sa i papërgatitur dhe i anshëm është gjyqësori në përfaqësimin e rasteve të shpifjes. Shumë lehtë mund të shkoj aq larg sa të përdoret për të shukurat mediat dhe të krijoj precedent të keq që nuk ka ekzistuar më parë në Kosovë (siç ekziston në shume vende të rajonit). Kjo mund të inspiroj auto-censurë të mëtejshme dhe të dëmtoj pavarësinë e mediave.

## Integriteti profesional

E drejt e lirisë së shprehjes dhe e drejta e privatësisë ndikohen në mungese të autoriteteve rregullatorë dhe gjyqësore, me ç’rast integriteti i mediave digjitale vihet në pikëpyetje. Sa profesionale janë organizatat e mediave digjitale në mbrojtjen e të drejtave bazike të njerëzve? Këtu niveli i integritetit të mediave është thelbësor për të parandaluar mediat digjitale që të shkelin të drejtën e privatësisë, që do të thotë se gazetaria duhet të llogarisë në gjykimin profesional të tyre. Gjatë hulumtimit studimor, gjetjet kryesore zbulojnë se sa mund mediat digjitale të arrijnë një baraspeshim mes të drejtës së lirisë së fjalës dhe të drejtës së privatësisë.

Ne Kosovë, mediat digjitale nuk janë të shqetësuara me shkeljen e të drejtës së privatësisë dhe fshehtësisë. Mungesa e pavarësisë së mediave dhe kapaciteteve profesionale tregon se mediat digjitale me vështirësi i mbajnë standardet etike të gazetarisë dhe udhëheqjes së mirë (dmth, përdorimi i burimeve të shumëfishta, publikimi i artikujve të cilësisë së

---

**99** Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 36, fq. 10

100

Reporterët pa Kufi. Gjykata e apelit e Kosovës merr anën në kundërshtim të Ueb Faqes Investigative, Tetor 2016



lantë, dhe mbrojtja e të drejtës autoriale dhe të privatësisë). Ne përgjithësi, mediat digjitale janë relativisht me te predispozuara për pandershmëri institucionale dhe varësi kontradiktore (qoftë politike ose financiare). Rritja e vazhdueshme e shpifjeve si armë politike kundër tjerëve është shembulli më i mirë sa larg mund të shkojnë mediat digjitale për të fituar fuqi politike ose për të fituar një pagë dhe të rris përfitimet nga reklamat. Redaktorët dhe gazetarët kanë tendencë të mos e marrin parasysh riskun që vije nga shpifja. Nuk është sepse atyre u pëlqen të fyejnë disa individ të caktuar. Është sepse zotëruesit e tyre kërkojnë që ata të bëjnë këtë për arsye financiare dhe politike.

Gazetarët raportojnë në pajtim me atë se çfarë redaktorët dhe zotëruesit e tyre pajtohen, në kuptimin e asaj se çfarë lloj ngjarje duhet të publikohet që u përshtatet preferencave. Nga perspektiva e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG), "konkurrenca dhe presioni komercial (në mbarë botën) po i shkaktojnë plagë të thella në trupat e gazetarisë."<sup>101</sup> Tensionet e vazhdueshme mes kërkesës për përfitime dhe gazetarisë etike e vendosin gazetarinë në "një pozitë të parehatshme dhe të paqëndrueshme,"<sup>102</sup> duke pasur parasysh situatën e pafavorshme ekonomike në vend dhe kushtet e dobëta të punësimit në industrinë e mediave. Për shembull, gazetarët në Kosovë paguhen keq, punojnë orë te gjata dhe nuk gëzojnë benefitet e sigurimeve. Kjo i bënë ata me të ndjeshëm ndaj auto-censurës dhe janë të prirë të dorëzohen par ndikimit financiar dhe politik.

Ngritja dhe fuqia e mediave sociale nuk mund të injorohet më deri në atë pikë sa të japin lajme të personalizuara. Rritja e përdorimit të pajisjeve mobile i ka ndihmuar përmirësimit të qasjes në media sociale gjë që është duke u përdorur nga profesioni i mediave si platformë për te komunikuar lajme drejtpërdrejtë tek një audiencë më e gjerë. Çfarë postohet në Facebook shume lehtë gjurmohet dhe shpërndahet përmes mediave online në Kosovë. Kjo e bënë të vështirë për mediat digjitale të ndajnë kufijtë e informacionit në mes përdorimit personal dhe profesional ose të thashethemet ose të vërtetës. Në praktikë, mediat sociale mund të keqpërdorën shume lehtë si një mjet informimi për të manipuluar opinionin publik duke pasur parasysh nivelin e ulët të arsimimit në vend.

Mediat sociale janë aplikacione interaktive me bazë në internet që gjithnjë e më shume po përdoret në Kosovë, sikurse edhe në vendet

101 Ëhite, Aidan. Faktori Besim. Ethical Journalism Netëork. 2016, fq. 138.

102 Collaku, Petrit. Indikatorët e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë. Dhjetor 2016, fq. 138



tjera, për të krijuar dhe transmetuar lajme false. Këto janë lajme tërësisht të fabrikuara dhe qëllimi i tyre është të rris shpërndarjen online dhe përfitimet nga klikimet në internet. Sipas The Guardian, “lajmet false shkruhen dhe publikohen në internet për të ç’orientuar në mënyrë që të përfitohet financiarisht ose politikisht, shpesh me kryetituj senzacionalist, të tepruar, ose dukshëm false për të tërhequr vëmendjen.”<sup>103</sup> Lajmet false zakonisht i mbulojnë çështjet të cilat i joshin emocionet e njerëzve, por, në realitet janë tërësisht të shkëputura nga e vërteta që shpesh mund të jetë fyese për disa individ të caktuar. Dy lajme e fundit false në lidhje me (a) zgjedhja e Donald Trumpit do të çonte tek tërheqja e mbështetjes së Shteteve të Bashkuara për pavarësinë e Kosovës, dhe (2) spekulimet në Shkurt 2017 për zgjedhje të parakohshme në Kosovë.<sup>104</sup>

Gjetjet tregojnë se – përderisa mediat në përgjithësi pretendojnë se përfaqësojnë interesin publik – shumicën e rasteve ata veprojnë në emër të interesit të vet dhe kanë për qëllim të rrisin lexueshmërinë. Shumicën e kohës audiencia në Kosovë është e interesuar të lexoj ose dëgjoj për ngjarje të cilat nuk janë të interesit publik. Në vend të kësaj, ata kërkojnë ngjarje që janë më argëtuese dhe që u joshet interesit të tyre personal. Kosova si një shtet i vogël është shndërruar në një shoqëri vëzhguese ku e drejta e privatësisë është shpesh në rrezik. Sigurisht që ka përjashtime, pasi një numër i organizatave të mediave janë vetëdijesuar për ndjeshmërinë e çështjeve të fshehtësisë së publikimit të përmbajtjes së caktuar. Organizata më të njohura profesionale (p.sh kallxo.com) aplikojnë standardet bazike etike të tregimit të vërtetës kontrollit të fakteve dhe kuptimit të mirë të çështjeve para se t’i publikojnë ato.

Megjithatë, në përgjithësi, mediat digjitale nuk janë të afta të arrijnë baraspeshën mes interesit privat dhe publik. Për një arsye, nuk ka parametra të qartë ligjor rreth asaj se çfarë konsiderohet interes privat e çfarë interes publik. Gjetjet tregojnë se mediat digjitale nuk janë të pajisura mirë për të dalluar mes mjediseve private dhe mjediseve publike (p.sh nëse një figurë publike fotografohet nga distanca duke e puthur një grua, a është çështje private ose publike). Prandaj, nuk është e rralle të shohim mediat digjitale, që në emër të interesit publik, të ndërhyjnë në të drejtën e individit për privatësi. Çka është më e rëndësishme, mediat digjitale hezitojnë të sqarojnë dhe të mësojnë me saktësisht se çfarë nënkuptohet me mjedise private dhe publike. Për shembull, askund

103 Hunt, Elle. Çka janë lajmet false? Si t’i ndalim dhe çfarë mund të bësh ti për t’i ndalur. Dhjetor 2016. [e qasur me 28 Prill 2017]

104 Balkan Insight. Lajmet false dhe puçet kontroverse [në Balkans]. Mars 2017 [E qasur me 26 Prill 2017]

në rregullat e brendshme të asnjë organizate të medias, duke përfshirë edhe Komisionin e Mediave dhe Këshillin e Mediave, nuk ka hapësira të definuar (p.sh hapësira të mbyllura dhe ato publike). Edhe kodi i etikës i Komisionit për Media dhe Këshillit të Mediave dështon të bëjë dallimin mes hapësirës publike dhe private.

Kur është fjala për cenimin e të drejtës së privatësisë së fëmijëve dhe viktimave (në kohe të pikëllimit dhe fatkeqësisë, ose vetëm ekspozimi i ndonjë tipi të sjelljes), mediat digjitale janë relativisht të kujdeshme në publikimin e fotove dhe videove. Në veçanti, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është i shpejtë dhe reagues në arritjen e një gjykimi i dhe marrjen e vendimit, kryesisht në formë të vërejtjes, se një transmetues konkret është i paaftë. Nëse krahasohen me mediat online, subjektet transmetuese janë më të kujdeshme në këtë fushë,<sup>105</sup> pasi ata kanë më shumë liri veprimi në përmbajtjen e tyre dhe mundësojnë me pak interaksion me publikun.

Mediat transmetuese shpesh kërkojnë miratimin nga prindërit – ne raste të fatkeqësisë – për të transmetuar një program për qëllime edukative ose bamirësie si informacion i vlefshëm për publikun e gjerë. Megjithatë, është përgjegjësi e KPM-së të konfirmoj miratimin por gjithashtu edhe të caktoj nëse shikimi ishte i justifikuar për interesin publik. Ata raportojnë një numër sfidash për përcaktimin e asaj nëse dikush dëshiron të dal pas një ngjarje të rënde. Mediat digjitale ose shtypi online është më pak i kujdesshëm pasi ata ndajnë një nocion më të gjerë të interesit të publikut dhe, në emër të tij, kanë tendencë të ndërhyjnë në privatësinë e njerëzve sepse u jep atyre një përparësi konkurruese për publikim të shpejtë dhe ndoshta informacione shpifëse në internet.

Në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, trajnimet e mediave kanë marrë vëmendje të shtuar në Kosovë. Përveç institucioneve të mediave, organizatat vendore dhe të huaja kanë luajtur një rol të rëndësishëm në programet e trajnimeve. Komuniteti ndërkombëtar ka ndihmuar shumë në aspektin e ndërtimit të kapaciteteve, dhe homologët e tyre vendor ishin përfituesit kryesor si për shembull Instituti i Mediave të Kosovës dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK). IMK është themeluar si një qendër e pavarur e mediave për modernizimin e aktiviteteve trajnuese në vend. Këshilli gjithashtu është themeluar me ndihmën e

105 Zejnullahu, Ardita. Asociacioni i transmetuesve të pavarur të mediave në Kosovë (ATPM). Intervistë. 23 Mars 2017



komunitetit ndërkombëtar. Deri më sot, është funksionale dhe udhëheq një program trajnimesh mbi etikën dhe gazetarinë,<sup>106</sup> të përshtatura për studentët e gazetarisë dhe ata të cilët kane hyrë së voni në profesion. Megjithatë, me kohe përfshirja ndërkombëtare ka rënë. Kjo ka qar tek shpenzime modeste alokimi dhe koordinime të dobëta në ndërtimin e kapaciteteve. Organizatat vendore të mediave kanë pësuar më së shumti, si pasojë ku ka rënie të kualitetit dhe ndikimi i trajnimeve në integritetin e gazetarit. Këshilli i Mediave ka dështuar të përditësoj programin e trajnimeve, dhe deri më sot, programi nuk i përmbush nevojat konkrete të mediave digjitale. Nuk është i përqendruar në çështjet praktike. Dhe as e drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave nuk janë pjesë të programit. Ngjashëm, Asociacioni i Gazetarëve nuk ka burimet financiare the humane për të kryer profesionin duke promovuar parimet e integritetit. Nuk është vetëm se etika nuk mësohet mjaftueshëm në trajnime, por gjithashtu nuk fuqizohet përmes kodit të sjelljes.<sup>107</sup>

Në Kosovë, ka mungesë të vetëdijes në mesin e gazetarëve rreth rëndësisë dhe përgjegjësisë së komunikimit masiv sa i përket respektimit të drejtës së privatësisë. Si rezultat, mediat digjitale nuk janë të afta për raportim fer the të saktë në rastet të cilat lidhen me çështjet si privatësia dhe reputacioni. Duke i pasur parasysh mundësitë e kufizuara për zhvillim profesional dhe për më tepër mekanizma gjyqësore të dobëta, mediat digjitale janë të prira të anashkalojnë ligjet që kanë lidhje me çështjet e privatësisë dhe reputacionit. Përderisa industria e mediave digjitale është “ekstremi” e parregulluar, do me thënë që askush s’mund të mbahet përgjegjës, do të ketë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut.

---

106 Mushkolaj, Imer. Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës (KMShK). Intervistë. 14 Shkurt 2017  
107 Collaku, Petrit. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). Intervistë. 7 Shkurt 2017

## Rekomandimet

Ky studim konstaton se mediat digjitale ka mangësi në aspektin e llogaridhënies dhe integritetit. Gjithsesi, kjo sugjeron që legjislacioni primar duhet të amendementohet ose disa dispozita dhe rregulla duhet të shtohen në ligjet ose institucionet (p.sh licencimi i mediave online). Deri më tani, raporti vetëm ka lavdëruar legjislaturën vendore për vendosjen e rregullave bazë në favor të lirisë së shprehjes. Megjithatë, duhet të ekzistojnë disa kufizime ose mbikëqyrje më e madhe e përmbajtjes online, gjë që mund të bie në përgjegjësinë e Komisionit të Pavarur për Media (KPM). Në Kosovë, nuk është arritur ende baraspesha mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për privatësi/reputacion për disa arsye:

Fakti që mediat digjitale janë të parregulluara për shkak të mekanizmave të dobët të llogaridhënies të rregullatorëve të mediave dhe institucioneve gjyqësore, dhe

Ka mungesë të pavarësisë së mediave dhe integritet në promovimin e standardeve etike të gazetarëve profesional kundër shpifjes dhe fyerjes. Si ti tejkalojmë këto sfida, kërkohen zgjidhje praktike të hartuara në pajtim me një numër rekomandimesh të dedikuara për institucionet e mediave dhe gjyqësore si në vijim.

### Institucionet e mediave

Institucionet e mediave duke përfshirë Komisionin e Pavarur për Media, Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës të respektojnë, mbrojnë dhe promovojnë të drejta reciprokisht të zbatueshme të njeriut siç janë e drejta e lirisë së shprehjes dhe e drejta e privatësisë. Ja vlen të mbahen të ndershme mediat digjitale për publikun në tërësi dhe për zhvillimin e demokracisë.

Me ligj, Komisioni i Mediave t'i jepet përgjegjësia e mbikëqyrjes së shtypit online (pa fuqi licencuese) dhe t'i mbaj përgjegjës përmbajtjen online që është e dëmshme për reputacionin e individëve.

Komisioni i Mediave të bëhet më proaktiv në sanksionimin e transmetuesve të cilët prodhojnë dhe shpërndajnë përmbajtje të dëmshme.

Këshilli i Mediave të marrë më shumë përgjegjësi për administrimin dhe të ndihmoj përfaqësimin e rasteve të shpifjes në gjykata në koordinim me Komisionin e Mediave

Këshilli i mediave të promovoj Kodin e Etikës dhe t'i nxis gazetarët të punojnë më shumë duke u bazuar në pasion të tej-çmueshëm sepse



është e domosdoshme të raportohet në emër të interesit publik Këshilli i mediave të përditësorj dhe organizoj më shpesh modulet e programit të trajnimit dhe ti bëjë të detyrueshme trajnimin e gazetarëve (të rinj e të vjetër) mbi etikën dhe gazetarinë.

Asociacioni i gazetarëve të filloj ose t'i bashkohet ndonjë iniciative për etikë te gazetarisë ose ndonjë projekti për të krijuar dhe mbajtur standardet etike në profesionin e gazetarisë.

### Institucionet gjyqësore

Vetë-rregullimi i mediave digjitale është një model i sigurt për përgjegjësi të mediave. Në fakt, rekomandohet shumë në vendet post-socialiste të cilat hezitojnë të kenë rregullator shtetëror, gjë që e konsiderojnë si relik i së kaluarës. Megjithatë, në mënyrë që të vihet në efekt llogaridhënia demokratike siç është rasti me vetë-rregullimin, duhet të ketë sundim të ligjit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të mbështes programet e ndërtimit të kapaciteteve përmes Institutit të Drejtësisë dhe/ose organizata të mediave për trajnime të gjyqtarëve mbi shpifjen dhe fyerjen.

KGJK duhet të hartoj dhe nisë një fushatë për informim të publikut rreth të drejtave ligjore që qytetarët kanë ndaj kërcënimeve potenciale të mediave sa i përket shpifjes dhe fyerjes.

KGJK duhet të përgatis dhe të nënshkruaj një Memorandum të mirëkuptimit me Këshillin e Mediave i cili do të kërkoj që gjykatat të trajtojnë rastet e shpifjes me prioritetin më të madh.

Në qendër të çfarëdo iniciative ose veprimi që fillon nga rekomandimet e përmendura është respekti dhe mbrojtja e aftësisë së individit për të jetuar lirshëm dhe me dinjitet. Nëse liria e shprehjes kufizohet ose kërcënohet në çfarëdo mënyre, individët nuk do të ishin në gjendje të rrisin ndjenjën e vetes. Por pa privatësi, ata nuk do të mund të zhvillojnë një ndjenjë të zërit të tyre. Së fundi, ky raport është një thirrje nga gazetarët dhe organizata e tyre që të ndezin një etikë pozitive për profesionin e gazetarisë. Gjithashtu është një ftesë për politik-bërësit dhe për publikun në përgjithësi t'i bashkohen debatit rreth asaj se si në duhet të formojmë mediat digjitale në të ardhmen në favor të mbrojtjes dhe nxitjes të së drejtave të njeriut.

## Shtesat

### Shtesa 1 | Vështrim i Literaturës

Një listë e shkurtër e burimeve të literaturës së përdorur për të ekzaminuar mediat digjitale dhe për t'i shikuar praktikat më të mira paraqiten në pjesën në vazhdim. Të gjitha burimet janë vegëzuar për qasje online dhe paraqiten në rend kronologjik. Faqet zyrtare të secilit autoritet rregullator dhe të gazetës zyrtare janë konsultuar rregullisht për t'iu qasur dokumenteve kyçe ligjore dhe raporteve të institucioneve.

#### Burimet lokale

1. Sheremeti, Fortuna. Përkundër dykuptimësive, mediat duhet të mbajnë standarde profesionale. 2017
2. Çollaku, Petrit. Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarisë në Kosovë. Dhjetor 2016
3. Komisioni Evropian (KE). Raporti i Progresit për Kosovën 2016. Nëntor 2016
4. Bordi i Hulumtimeve dhe Shkëmbimeve Ndërkombëtare (IREX). Indeksi i Qëndrueshmërisë e mediave në Kosovë
5. Gashi, Krenar. Kombet në tranzit 2015. Freedom House. Qershor 2016
6. Kosovo 2.0, Çohu dhe KMSHK. Liria e shprehjes, medias dhe informacionit në Kosovë. Maj 2016
7. Fondacioni Thomson. Manual i rasteve kryesore në KEDNj. Maj 2016
8. Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Puls i Publik. Maj 2016
9. Komisioni i Pavarur për Media (KPM). Raporti vjetor 2014. Mars 2015
10. OSBE. Liria dhe siguria mediale e gazetarëve në Kosovë. Qershor 2014.

#### Burimet ndërkombëtare

1. Fjalori Ligjor <http://www.yourdictionary.com/>. (Qasur në Shkurt 2017)
2. White, Aidan. Faktori i besimit. Ethical Journalism Network. 2016
3. Speller, Catherine. Një vlerësim i nevojave të këshillave të mediave në Evropën Juglindore. Qershor 2015
4. IMLM dhe INSh. Liria e shprehjes, ligji i mediave dhe shpifja. Shkurt 2015.
5. Petkovic, Brankica. Çështjet e integritetit të mediave. Instituti i Paqes. 2014
6. Wong, Cynthia dhe James X. Dempsey. Mediat dhe përgjegjësia për përmbajtjen në internet. Maj 2011.
7. Packard, Ashley. Ligji i mediave digjitale. Wiley-Blackwell. 2010, fq. 180



8. Aidan, White. T'ju them të vërtetën. Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve. 2008
9. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNj). Dhjetor 1948.

## **Burimet ligjore**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM). Kodi i Etikës së Ofruesve të Shërbimeve të Mediave. Tetor 2016
2. Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04-L-137 mbi Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë. Gusht 2013
3. KPM. Rregullorja mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Mediat Audio Vizuale. Maj 2013
4. KPM. Rregullorja 12/1 mbi Rregullat dhe Procedurat. Shtator 2012
5. Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-044 mbi Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Prill 2012
6. Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 02/L-065 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Maj 2008.
7. KMSHK. Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Pa datë.
8. Kushtetua e Republikës së Kosovës. Qershor 2008.



## Shtesa 2 | Lista e të anketuarve

Emrat dhe mbiemrat e individëve të cilët janë intervistuar për këtë hulumtim janë listuar në radhitjen si vijon.

Emri/Mbiemri	Pozita/Tit	Institucioni/Organizata
Albert Avdiu	Ish drejtor	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Ardita Zejnullahu	Asociacioni i Pavarur i Mediave Elektronike	
Driton Zhubi	Drejtor Ekzekutiv	Lens
Flutura Kusari	Ekspert i pavarur	Ish bashkëpunëtore e BIRN
Genc Nimoni	Koordinator i Projektit	ÇOHU/Preporter
Imer Mushkolaj	President i Bordit	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Naile Krasniqi	Drejtor Ekzekutiv	Komisioni i Pavarur për Media
Petrit Collaku	Hulumtues	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



## Shtesa 3 | Pyetësori i Strukturuar

Struktura e pyetësorit përbëhet nga pyetje bazike rreth kornizës ligjore dhe rregullatore dhe pyetjeve specifike mbi risqet e llogaridhënies dhe kërcënimet e integritetit.

### Ligjet dhe Rregulloret

Në çfare mase ka masa mbrojtëse për lirinë e shprehjes, të drejtës për privatësi dhe media?

Nënpyetje: Çfarë thonë ligjet për të drejtën e privatësisë, lirisë së shprehjes dhe mediave?

Në çfarë mase ofron legjislacioni një ambient të përçueshëm për mediat digjitale?

Nënpyetje: A ka dykuptimësi në ligj? A ka ndonjë dispozitë ligjore jo-konsistente?

Cilat institucione janë përgjegjëse për rregullimin e mediave digjitale?

### Llogaridhënia institucionale

Në çfarë mase mund të mbahen përgjegjëse me ligj dhe në praktikë mediat digjitale?

Çfarë përvoje kanë këto institucione në rregullimin e mediave?

Si mund disa video the fotografi të caktuara të hiqen nëse ka ankesë ligjiore?

### Vendimet gjyqësore

Cilat janë disa nga mekanizmat e zbatimit të ligjit në fuqi për t'i adresuar mosmarrëveshjet e mediave digjitale?

A po përgjigjen institucionet publike mirë ndaj ankesave të qytetarëve?

### Integriteti profesional

A janë të shqetësuara mediat digjitale rreth cenimit të të drejtës së privatësisë, shpifjes, dhe fshehtësisë?

A janë mediat të afta të arrijnë një baraspeshë mes informacionit privat dhe interesit publik?

Sa të kujdesshme janë mediat digjitale për të drejtën e privatësisë së fëmijëve dhe viktimave (p.sh publikimi i fotove etj)?

Sa janë të arsimuar dhe të trajnuar janë ata mbi çështjet e shpifjes dhe fyerjes?

A janë mediat të afta për raportim të drejtë dhe të saktë të procedurave ligjore?

Zbatuar nga:



Projekt i financuar nga BE-ja  
dhe i menaxhuar nga Zyra e  
Bashkimit Evropian në Kosovë

Ky punim është bashkë-financuar nga:

